

1 E martë, 16 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancë, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
13 procesverbal që të akuzuarit janë të katërt të pranishëm në
14 sallën e gjyqit.

15 Përpara se të vijojmë më tej me dëshminë e Dëshmitarit
16 04752, ka një çështje paraprake që Trupi Gjykses dëshiron ta
17 trajtojë.

18 Dje, Mbrojtja e Thaçit kundërshtoi nxjerrjen nga ZPS-ja
19 të një dokumenti që rrodhi nga kundërpyetjet e Mbrojtjeve për
20 Dëshmitarin 04753 në listën e dokumenteve të Prokurorisë.
21 Trupi Gjykses e lejoi këtë dokument që të paraqitej në listën
22 e dokumenteve të Prokurorisë. Duke marrë parasysh vendimin e
23 Trupit Gjykses që e lejoi ZPS-në të përdorte një dokument të
24 përdorur paraprakisht nga Mbrojtja e z. Thaçi -- Mbrojtja e z.
25 Thaçi i kërkoi Trupit Gjykses që të zbatonte të njëjtin parim

1 edhe për dokumentin që Mbrojtja dëshiron të shtojë në listën e
2 dokumenteve të tyre në qoftë se do të duhet që të bëjnë pyetje
3 lidhur me dokumente të tilla të përdorur nga Prokuroria.

4 Trupi Gjykses rikujton se ka lejuar pyetje plotësuese në
5 pajtim me rregullën 127(3) dhe (1) të rregullës 11 [Sipas
6 përkthimit] mbi Urdhrin për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor,
7 vetëm për çështje të cilat dalin nga kundërpyetjet me lejen e
8 Trupit Gjykses. Në qoftë se pala thirrëse dëshiron që të
9 paraqesë dhe të përdorë dokumente për një dëshmitar gjatë
10 pyetjeve plotësuese, ajo duhet që ta ngarkojë këtë material në
11 listën e provave të veta në përfundim të kundërpyetjeve dhe
12 nuk është e nevojshme që të kërkojë leje për paraqitjen e
13 këtij dokumenti në listën e provave të veta.

14 Trupi Gjykses gjithashtu rikujton që ka lejuar pyetje nga
15 pala tjetër me lejen e Trupit Gjykses, në pajtim me paragrafin
16 112 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor kur pyetjet
17 që i janë bërë dëshmitarëve nga Trupi Gjykses pas
18 kundërpyetjeve dhe pyetjeve plotësuese ngrenë çështje
19 tërësisht të reja.

20 Në qoftë se një palë dëshiron që të paraqesë dokumente
21 për një dëshmitar gjatë pyetjeve të veta, duhet që dokumenti
22 përkatës të mund ta paraqesë në listën e provave të veta
23 menjëherë pas përfundimit të pyetjeve nga Trupi Gjykses dhe
24 nuk është e nevojshme që të kërkojë leje për ta nxjerrë këtë
25 dokument në listën e provave të veta. Lista e materialeve të

1 të gjithave palëve të cilët planifikojnë që të bëjnë pyetje që
2 dalin nga pyetje të bëra nga Trupi Gjykses duhet që të bëhet
3 menjëherë publike për palët.

4 Z. Misetic, e kuptoj që doni të bëni një koment, apo jo?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, na kaloni në seancë
6 private për komentin përkatës.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi kthyer përsëri në seancë publike.

8 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
11 z. Zyrapi.

12 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj
14 edhe një herë që të përpiqeni t'i jepni përgjigje pyetjeve
15 qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni
16 pyetjen, lirisht mund t'i tregoni avokatit ose palës përkatëse
17 që të bëjë shpjegimin e mëtejshëm të pyetjes, ose thoni që nuk
18 e kuptoni pyetjen. Po ashtu na jepni bazën e njohurive,
19 fakteve dhe rrethanave mbështetur në të cilën do t'ju bëjnë
20 pyetje.

21 Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej
22 pesë sekondash përpara sesa t'i jepni përgjigje pyetjes dhe
23 flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin plotësisht
24 përkthyesit.

25 Nëse e keni të nevojshme që të bëni pushime, ju lutem na

1 e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme.

2 Ju kujtojmë që jeni ende nën detyrimin që të thoni të
3 vërtetën, siç keni thënë dhe deklaruar në betimin solemn.

4 Ju rikujtoj gjithashtu, siç e kam përmendur edhe javën më
5 përpara që në qoftë se ju bëhet një pyetje që mund të jetë
6 vetëinkriminuese, nuk është e nevojshme që t'i përgjigjeni
7 kësaj pyetjeje, me përjashtim të rastit kur Trupi Gjykses ju
8 detyron që t'i përgjigjeni pyetjes përkatëse. Në qoftë se do
9 të keni nevojë, mund të mbështeteni gjithashtu edhe te avokati
10 kujdestar i caktuar për ju.

11 Tani do të vazhdojmë me pyetjet plotësuese nga
12 Prokuroria. Ju lutem dëgjojeni me vëmendje Prokuroren dhe
13 përgjigjuni pyetjeve përkatëse.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

15 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

16 Pyetje vijuese nga znj. Lawson [Vazhdim]

17 PY. Mirëmëngjes.

18 PË. Mirëmëngjesi.

19 PY. Po flasim për periudhën kur ju keni qenë jashtë Kosovës
20 në shtator dhe tetor 1998. Avokati i z. Krasniqi iu lexoi një
21 pjesë të informacionit relevant nga Shënimi Përgatitor i
22 Prokurorisë, që për procesverbal është në faqen e transkriptit
23 T18026. Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje të tjera shtesë për të
24 paraqitur informacionin që nuk iu paraqit juve.

25 Kur keni qenë jashtë Kosove gjatë asaj periudhe kohe,

1 Dëshmitar, a keni patur kontakt të drejtpërdrejtë me anëtarë
2 të Shtabit të Përgjithshëm që asokohe ishin në Kosovë?

3 PË. Jo.

4 PY. Edhe pse ai nuk ishte ende anëtar i Shtabit të
5 Përgjithshëm, a keni pasur kontakt të drejtpërdrejt me Fatmir
6 Limën, Dëshmitar?

7 PË. Jo.

8 PY. A ka pasur anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm jashtë
9 Kosove që ju kanë dhënë ju informacion lidhur me atë se çfarë
10 po ndodhte brenda Kosovës, Dëshmitar?

11 PË. Me jashtë Kosovës ka qenë komandant i përgjithshëm, Azem
12 Syla.

13 PY. A ka pasur anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm
14 jashtë Kosove që iu ka dhënë juve informacion për ngjarjet ose
15 zhvillimet në Kosovë gjatë asaj periudhe, Dëshmitar?

16 PË. Jo.

17 PY. A keni patur kontakte me Kadri Veselin gjatë asaj
18 periudhe kohe, Dëshmitar?

19 PË. Me Kadri Veselin më pas, pasi jam kthye nga perëndimi
20 edhe kemi fillu bisedimet me Qeverinë Bukoshi, por jo ma
21 herët.

22 PY. Iu tregua një deklaratë e Mensur Kasumit gjatë dëshmisë
23 tuaj, kështu dëshiroj t'ju bëj disa pyetje plotësuese lidhur
24 me këtë dokument.

25 Së pari, Mensur Kasumi a ka qenë ndonjëherë përgjegjës

1 për drejtorinë operative të UÇK-së?

2 PË. Jo përgjegjësinë për drejtori operative, por ka qenë në
3 drejtori operative. Po më shumë e kam pas ngarkuar në atë kohë
4 deri sa është kthyer Veseli për me informue për G2, për
5 zbulimin. Për të më informuar për lëvizjet e forcave serbe dhe
6 forcën e tyre në atë kohë.

7 PY. Në rregull. Në paragrafin 6, ku ai thotë që është bërë
8 përgjegjës për drejtorinë operative, i takon që duhet të ketë
9 qenë ndonjë gabim.

10 Tani dua që t'ju pyes lidhur me prillin 1999, pas
11 krijimit të Qeverisë së Përkohshme, kur z. Kasumi thonë që
12 është bërë shef i ZKZ-së.

13 Në atë periudhë, pas kimit të Qeverisë së Përkohshme, a
14 ishte krijuar edhe SHIK-u, Dëshmitar?

15 PË. Me formimin e Qeverisë së Përkohshme në atë kohë ka fillu
16 edhe formimi i SHIK-ut.

17 PY. Kadri Veseli, pra kishte -- ishte bërë shef i SHIK-ut në
18 atë periudhë, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. A e dini se çfarë stafi ose çfarë anëtarësie kishte SHIK-
21 u, a e kishte lëvizur -- kishte ardhur njeri bashkë me z.
22 Veseli për t'u bërë pjesë e SHIK-ut?

23 PË. Jo, nuk e di atë. Se [E pakuptueshme] periudhën e ardhjes
24 së tij dhe fillimi i bombardimeve, luftimeve, nuk kam mujt të
25 di se kën i ka pas, dhe kën i ka pas afër në këtë drejtim.

1 PY. Do të kaloj te një temë tjetër. Do i kthehem përsëri
2 verës së vitit 1998. A kishin një njësi të siguruar --
3 sigurie, një njësit sigurie anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
4 të cilin mund ta përdornin herë pas here në atë periudhë?
5 PË. Po verës 1998 më së shumti janë marrë ushtarët prej
6 Brigadës 121, faktikisht, [E pakuptueshme] e Berishës, ku ka
7 qenë njësit Çeliku, prej aty të [E pakuptueshme] e kam
8 përcjellur ose kam qenë pjesë me siguri diku gjatë lëvizjeve.
9 Dhe vartësisht për aty folim për zonën e Pashtrik në qoftë se
10 kemi qenë në Berishë. Në qoftë se kemi qenë në Drenicë,
11 atëherë nga ana e Drenicës ushtarët e saj edhe kanë qenë të
12 angazhum që të na sigurojnë, ose në zona të tjera kur kemi
13 shku.
14 PY. Këto njësi ndonjëherë a kanë udhëtuar së bashku dhe a
15 kanë shoqëruar anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kur ata
16 lëviznin nga një zonë tek tjetra?
17 PË. Po, në qoftë se kemi lëviz prej një zone në zonën tjetër
18 na kanë përcjellë ushtarët e kësaj zone. Për shembull, marrim
19 të zonës së Pashtrikut ose po e marrim, kemi dalë në atë zonën
20 e Drenicës, deri aty na kanë përcjellë, aty pastaj janë kthyer
21 edhe kanë vazhdu me ushtarët e asaj zone që kemi qenë,
22 faktikisht, të Drenicës, në qoftë se kemi shku në Drenicë.
23 PY. Pra, për shembull, kur anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm
24 vizitonin Dukagjinin në korrik 1998, po anëtarë të njësitit
25 Berisha, a i përcillnin ata, i shoqëronin ata në zonën e

1 Dukagjinit, për shembull, sa për ilustrim?

2 PË. Po, për shembull, në këtë rast, se më kujtohet shumë
3 mirë, nga Berisha na kanë përcjellë deri te zona e Brigadës
4 122, faktikisht, të Malishevës, pastaj njësitë, ushtarët e saj
5 na kanë përcjellë deri në pjesën në kufi me Dukagjinin. Pastaj
6 prej hyrjes në pjesën e Dukagjinit na kanë marrë ushtarët e
7 njësisë të zonës së Dukagjinit edhe kur kemi hy deri te brenda
8 në zonën e Dukagjinit. Nganjëherë ka qenë edhe mundësia edhe
9 njësitë i cili ka qenë pranë që e ka komanduar Alush Agushi
10 edhe ajo na ka përcjellë, për shembull, prej Dukagjinit brenda
11 në brendësi deri te ku kemi dhe synimin të shkojmë në zonën
12 apo të Pashtrikut apo të Drenicës. Kështu që sa mbaj me mend
13 që kështu ka qenë në atë kohë.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykses
15 dëshiroj që të lexoj një pjesë të shkurtër të dëshmisë tuaj në
16 çështjen Haradinaj. Referenca është IT-04-84 T3256. Në faqen
17 3286 në versionin në anglisht që do të lexoj për ju,
18 Dëshmitar. Dhe faqja 31 në shqip.

19 PY. Pyetja që ju bëhet është kjo:

20 "Dhe më pas ju na thatë neve që ata janë shoqëruar në
21 Jabllanicë nga një grup ushtarësh në zonën e Berishën. A është
22 e vërtetë kjo?

23 "PË. Po.

24 "PY. A mund të ta them kështu: A i keni marrë hua
25 ushtarët nga njësitë Berisha për t'i dërguar ata në Jabllanicë?

1 "PË. Nuk e di çfarë do të thuash që 'i keni marrë hua'
2 por ka pas njësit të Shtabit të Përgjithshëm atje dhe ajo ka
3 qenë njësia që e përcillte Shtabin e Përgjithshëm në
4 Jabllanicë, pra njësia e sigurimit."

5 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po, e saktë. Unë edhe më parë e thashë ka qenë njësia e
7 Alush Agushit e cila ka qenë -- është e Dukagjinit dhe në atë
8 kohë ajo njësi na ka përcjellë prej atjehit, prej Dukagjinit e
9 drejt në Berishë.

10 PY. Sapo përmendët njësia që ishte në drejtimin e Alush
11 Agushit. A është njësitit Mala ky që ju keni përmendur më herët
12 në pyetjet që ju janë bërë, Dëshmitar?

13 PË. Po, Malaj, me pseudonimin Alush Agushi.

14 PY. Në cilën periudhë kohe pak a shumë mesatarisht ishte
15 njësia Mala që funksiononte nën drejtimin e Shtabit të
16 Përgjithshëm, Dëshmitar?

17 PË. Po duke marrë prej -- sa e maj mend unë kur kam shku në
18 q'atë kohë, kur kemi shku në korrik dhe ajo ka përcjellë tanë
19 kohën, ka qenë në përcjellje. Domethënë, prej kësaj kohe, në
20 atë kohë 1998 edhe në gusht 1998, edhe shtatori 1998 edhe kur
21 jam kthi prapë në Kosovë ai ka qenë.

22 PY. Cilat kanë qenë funksionet e veta? Juve na përshkruat
23 faktin që përcillnin ose shoqëronin Shtabin e Përgjithshëm, po
24 të tjera funksione shtesë, a ka patur, Dëshmitar?

25 PË. Po ajo njësi përveç që ka pas një pjesë që ka qenë në

1 përcjellje, po baza kryesore e saj ka qenë në zonën e
2 Dukagjinit, në fshatin -- tash s'më kujtohet emri i këtij
3 fshatit, ajo ka qenë atje e bazume edhe aty ka veprue.
4 PY. Të bënë pyetje lidhur me qasjen e anëtarëve të Shtabit të
5 Përgjithshëm dhe telefonat satelitorë në verën të vitit 1998.
6 Do t'ju lexoj ca pjesë të shkurtra të tekstit nga një gazetar
7 që ka qenë në Likovc dhe në Drenicë, pra në zonën e Likovcit
8 dhe të Drenicës nga fundi qershorit deri në shtator të vitit
9 1998.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
11 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00209434-ET. Faqja që
12 dëshiroj që të shohim është 209451.

13 PY. Pjesa e parë që do ju lexoj, Dëshmitar, është nga fundi i
14 qershorit të vitit 1998. Në versionin anglisht po lexoj nga
15 mesi i faqes.

16 "Ka disa karrige plastike nën pemë.

17 "'Serbët', filloi Luli ku u ulëm 'nuk do të lëmë kurrë të
18 largohesh, kurrë [Sipas përkthimit].'

19 "Ai nxjerr diçka që duket si laptop, e hap mbulesën dhe e
20 vendos me kokën lart. Hera e parë që shikoj një telefon
21 satelitor.

22 "'Më jep numrin', më thotë ai."

23 Pra, e para, a është e vërtetë që telefonat satelitorë
24 dukeshin pak si laptop ose kompjuter mobil, Dëshmitar?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kundërshtoj

1 pyetjen sepse mbi bazën e pyetjes pra, pyetja është drejtuese
2 nga ZPS-ja. Dhe kjo është pyetur më përpara nga Prokurorja në
3 deklaratën sipas rregullës 154, në Pjesën 14 faqja 12,

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë
5 dëshmitarin e kam pyetur në pyetjet paraprake se kur ka marrë
6 ai në telefon satelitor personalisht dhe nuk kam bërë një
7 pyetje të kësaj natyre që po bëj tani.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë [nuk] po flas për pyetjet e
9 drejtpërdrejta të bëra dëshmitarit. Dhe po them që në
10 intervistën e ZPS-së është e qartë në Pjesën 14, në faqen 11,
11 dhe vazhdohet më tej pastaj në faqen 12 se cila është dëshmia
12 e dëshmitarit sa i takon kësaj teme. Është shumë konkrete si
13 pyetje kështu që për këtë arsye mendojmë që nuk ja vlen që të
14 bëhet pyetja nga qershori deri në nëntor dhe pastaj në
15 dhjetor.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
17 rrëzohet.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]
19 PY. Tani pyetja që kam për juve, Dëshmitar, është kjo: A
20 është e vërtetë që telefonat satelitorë dukeshin pak si
21 laptop?

22 PË. Po, është e saktë. Se ka pas dy pjesë, pjesën që mund të
23 hapet si laptop, po pjesa e epërme që është dalë si -- si --
24 ne e quajmë ekrani, jo, nuk a kon ekrani, a kon antenë dhe ajo
25 është zakonisht vendosur jashtë edhe drejtuar në drejtimin ku

1 mund të ketë për komunikim.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit tani të
3 kalojmë në faqen 9465.

4 PY. Përsëri po lexoj nga mesi i faqes në versionin anglisht.
5 Ai thotë si më poshtë:

6 "[Një burrë i ri] më dërgon tek një person tjetër që e
7 kishte veshur kapotë kundër shiut, me ngjyrë të gjelbër, i
8 cili kupton gjermanisht dhe qesh me durim me zhgënjimet e mia,
9 për shkak se Luli është zhdukur dhe se askush nuk pranon të
10 merret me mua.

11 "'Kam dëgjuar për ty', më thotë me një zë të qetë. 'Luli
12 nuk është këtu. Pas ca ditësh do të jap më shumë informacion.
13 Nëse do të pyesësh për mua, emri im është Gjarpri. Ky emër
14 kupton Gjarpër'.

15 "Gjarpri më shoqëron tek një makinë ku ndodhet një
16 telefon satelitor. Telefoni shtëpinë dhe flas me dy prindërit
17 e mi."

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund të kalojmë tani në faqen
19 9472. Citimi tjetër që do të lexoj, Dëshmitar, është nga
20 shtatori i 1998.

21 PY. Po lexoj nga gjysma e dytë e faqes në versionin në
22 anglisht.

23 "Në mbrëmje, Gjarpri më thotë që do ta shoqëroj atë,
24 Qopën dhe Kapushin në një vend tjetër. Ai është në humor të
25 gëzueshëm dhe bën shaka se është i vetmi në makinë që nuk

1 çalon.

2 "Mënyra se si vozit Qopa, tregon se nuk e dinë se sa do
3 të zgjasë kjo. Rrotat rrotullohen nëpër baltë dhe pluhurat na
4 vijjnë nga të gjitha drejtimet. Mbërrijmë në një fshat që është
5 aty në një kodër shpejt. Gjarpri më thotë ta shoqëroj në
6 shtëpi. Në tavan është një llambë me parafinë. Pas perdes te
7 dritarja është një telefon satelitor.

8 "Më jep numrin' më thotë ai."

9 Kush e ka pasur nofkën Gjarpri?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, po ngrihem për
11 një arsye tjetër tani. Sa i takon intervistës së ZPS-së në
12 këtë intervistë jepen datat dhe këto pyetje të cilat duhet të
13 ishin bërë për pyetjet e drejtpërdrejta të bëra nga Prokuroria
14 në fillim dhe jo tani. Nuk është koha kjo për të bërë këto
15 pyetje. Kundërshtojmë.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
17 rrëzohet.

18 Vazhdoni, Prokurore.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

20 PY. Kush e ka pas nofkën Gjarpri, Dëshmitar?

21 PË. Po nofkën Gjapri e ka pasur Hashim Thaçi.

22 PY. Kush e ka pasur nofkën Kapush?

23 PË. Jo Kapush, po Kapuç a kon, është si pseudonim e ka pas
24 komandanti i brigadës, Mujë Krasniqi.

25 PY. Po nofkën Qopa, kush e ka pas përdor, Dëshmitar?

1 PË. Nuk e di tash se kanë pas dy-tre që kanë pas çalue si
2 Qopa, po cili saktë, nuk e di tash.

3 PY. Kush janë personat që ti i ke njoft dhe që ti e di që
4 kanë pas nofkën Qopa dhe kanë pas çalu?

5 PË. Çalimin e ka bo Sahit Jashri, ka pas. Sabit Geci ka pas.
6 Në zonën e Nerodimes është njëjtë, Qopa. Po tash nuk e di cili
7 prej tyre.

8 PY. Në rregull. E keni përmendur më herët që të dy, Sabit
9 Geci dhe Mujë Krasniqi ishin plagosur dhe që u transferuan për
10 trajtim në Shqipëri pak a shumë rreth shtator 1998. A është e
11 vërtetë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani do të kërkoja të kalonim në
14 faqen 9462.

15 PY. Po lexoj nga fillimi i faqes, Dëshmitar.

16 "Më vonë atë darkë futet një oficer në konvikt. Ai është
17 i gjatë, trupmadh, me mjekër të dendur dhe beretë në kokë.
18 Thotë që quhet Fehmi dhe që është komandant i zonës."

19 Pastaj i kaloj dy rreshta dhe vazhdoj më tej:

20 "I them Fehmiut nëse është e mundur të telefonoj
21 Ambasadën e Norvegjisë në Beograd. Del jashtë, merr një
22 telefon satelitor nga makina dhe ma jep nga dritarja. Pas disa
23 përpjekjesh lidhem me ambasadorin. Ai duket pak i çorientuar
24 nga kjo thirrje, por e kupton se unë nuk mund t'i tregoj se ku
25 në Drenicë ndodhem."

1 A ka pasur një komandant me emrin Fehmi në zonën e
2 Drenicës, Dëshmitar?

3 PË. Po, komandanti i brigadës Fehmi Lladrovci ka qenë.

4 PY. A është e vërtetë që ishte i gjatë dhe me mjekër?

5 PË. Po.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim materialin P12426.

7 PY. Në rreshtin 6 shohim emrin e Fehmi Lladrovci po ta
8 zmadhojmë. Dhe data në të majtë është maj 1998. Fehmi
9 Lladrovci a ka pas telefon satelitor?

10 PË. Nuk e di.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj të
12 pranohen tri faqet e dokumentit të mëparshëm për të cilat
13 komentoj dëshmitari. Pra, faqet që përfundojnë me 9449, 9472
14 dhe 9462.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] I njëjti kundërshtim që bëra më
18 herët. Këto pyetje duheshin bërë kur i bëri pyetjet fillimisht
19 dhe jo të bëhen gjatë pyetjeve plotësuese.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
21 SPOE00209434-ET --

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se të merrni vendim, a
23 t'ju pyes, i nderuar Gjykatës, nëse mund të bëjmë ne pyetjet
24 ne pas pyetjeve plotësuese, kundërpjetjet tona? Sepse po dalin
25 aspekte të reja tani. A do të na jepni mundësinë të bëjmë

1 kundërpyetje në fakt? Se po dalin materiale të reja që unë dua
2 t'i shqyrtoj më tej me dëshmitarin.

3 Kjo është një situatë e pazakontë për ne. Nëse po e
4 prezantoni një praktikë të tillë për herë të parë, atëherë për
5 ne kjo është situatë e pazakontë.

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbarojmë me
7 këtë pjesë dhe pastaj kur të jetë momenti i duhur, ju lutem,
8 bëni të qartë qëndrimin tuaj. Ose më saktë bëni kundërshtimin
9 tuaj.

10 Më falni, atëherë, a e thashë saktë numrin?

11 Pra, a është faqja 9449, 0472, 9462?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
14 pranohen. Le t'ju japim numrin përkatëse.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrin numrin,
16 P01449 dhe klasifikimin e kanë konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem më lejoni. Ne kemi
19 kërkesën që në qoftë se nuk na jepni ne të drejtën të bëjmë
20 kundërpëyetje, atëherë Prokuroria ta bëjë të qartë qëndrimin e
21 vet ku po do të dali.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I nderuar z. Misetiç,
23 paragrafi 112 i vendimit tonë, i urdhrit tonë e trajton shumë
24 mirë çështjen e pyetjeve plotësuese dhe thotë:

25 "Trupi Gjykes do të lejojë pyetje plotësuese vetëm nëse

1 prezantohen materiale të reja gjatë kundërpyetjeve apo
2 pyetjeve plotësuese.”

3 Kështu që kjo është e lejueshme dhe ju mund t'i përdorni
4 po ashtu materialet.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Emerson e ngriti kundërshtimin
6 e vet po nuk e morëm përgjigjen a do të lejohet apo s'do
7 lejohen kundërpyetjet.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të vendosim për këtë në
9 momentin e duhur.

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Këto materiale mund të
12 riklasifikohen si publike.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim]
14 Riklasifikojini si publike.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 materiali që mori numrin e provës P012449, do të
17 riklasifikohet si publik si në anglisht edhe në shqip.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem nxjerrim në ekran
19 materialin P01267.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] A doni të shfaqni edhe
21 transkriptin apo vetëm videon?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja të shihnim minutën e
23 parë të videos.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Pra, vetëm videon, jo
25 transkriptin?

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Videon dhe transkriptin në
2 anglisht.

3 [Luhet videoincizimi]

4 MUJË RUGOVA: "Pastron, pastron [E pakuptueshme], pastron
5 gjakin -- me 12 mars, pas ramjes së Jasharajve, në zyrën e
6 qeverisë në Bon kanë ardhë 14 ushtarakë, midis tyre Agim
7 Qelaj, si më kujtohet si sot. Pastaj ka qenë Bislum si
8 zakonisht, Salihu, Kemal Shaqiri, Rustem Berisha dhe të
9 gjithë kanë qenë të gatshëm me hy në frontin e luftës. Atë
10 ditë bare u zhvilloshin lufta në front, në front ishte edhe
11 Kadri Veseli dhe u lidh me telefon, u lidh me telefon,
12 bisedon, thotë 'Profesor, nigjoi granatimet që i bën Serbia
13 kundër popullatës. Ne jemi në front.' Agim Qelaj mu lut,
14 'Profesor, muj me marrë telefonin', i dhashë telefonin edhe si
15 themi ne, niset shkurt, e mësonte kështu duhet të bahet
16 istikami, futni këtu, në atë në këtë. Me lot në sy e kemi
17 mbyll atë takim, e kemi mbyll atë takim, dhe Agimi ka qenë i
18 gatshëm prej atyhit me u nis menjëherë për front."

19 MASHKULL I PANJOHUR 1: "Pas betejës së Likoshanit ..."

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të ndalojmë.

21 PY. A ju kujtohet ky takim, pikësëpari, dhe a e njihni
22 personin që po flet në video?

23 PË. Po, personi që flet është Mujë Rugova. Po, kam qenë në
24 atë takim.

25 PY. A ju kujtohet që Agim Qelaj e ka marrë telefonin edhe ka

1 folur me të -- me telefon me Kadri Veselin?

2 PË. Nuk më kujtohet kur është bërë kjo bisedë. Në atë kohë
3 nuk kam pa.

4 PY. Ju keni shkuar atje gjatë kohës që po bëhej thirrja
5 telefonike, kështu?

6 PË. Jo, në atë kohë kur kemi shku që po e përmend Mujë Rugova
7 është një takim ku kemi shku të gjithë ish-oficerët, të cilët
8 kemi pas përvojë luftë, dhe kemi kërku që të kyçemi sa më
9 shpejt për t'i ndihmuar atyre djemve në Kosovë. Dhe kur folët
10 për çështjen e Mujë Rugovës dhe Kadri Veseli, Mujë Rugova dhe
11 Kadri Veseli kanë majt kontakte tanë kohën, se e di se mbas
12 kësaj se kam pas kontakte me Mujën në atë kohë edhe me
13 Fehmiun, edhe kur janë -- ky kontakt ka vazhdue edhe
14 mëtutjeshëm.

15 E di që profesor [E pakuptueshme] ka qenë profesori dhe
16 studentët, studenti ka qenë Kadri Veseli edhe Hashim Thaçi
17 kurse profesori, Mujë Rugova. Në këtë drejtim e di që është
18 mbajt edhe kështu jemi kyç edhe ne si eprorë kur kemi fillu të
19 vijmë në Shqipëri edhe në Kosovë.

20 PY. Faleminderit për sqarimin. Mesa kuptoj nga përgjigja
21 juaj, ju nuk e kujtoni konkretisht atë thirrje telefonike që
22 përshkruan Mujë Rugova në këtë video, kështu?

23 PË. Po. Jo, nuk më kujtohet fare që është bërë telefonatë me
24 telefon që ka biseduar Agimi Qelaj me Kadrien se nuk ma ka
25 thënë në atë kohë dhe nuk e mbaj mend.

1 PY. Faleminderit. Një nga avokatët mbrojtës iu pyeti për
2 rregullat e përkohshme për organizimin e UÇK-së, kur u krijua
3 kjo rregullore, edhe thatë që dëshmia që po jep këtu është e
4 ndryshme nga dëshmia që ke dhënë më herët lidhur me këtë
5 rregullore.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
7 materialin IT-05-87_1 T2423. Në anglisht faqja 2452. Dhe në
8 shqip faqja 32.

9 PY. Në ekran do të shohim dëshminë që i keni dhënë gjykimit
10 Djordjevic për ish-Tribunalin e Hagës. Pyetja që ju kanë bërë
11 ka qenë kështu:

12 "Faleminderit, z. Zyrapi, por këto kanë qenë rregullore
13 të përkohshme dhe organizimi i çështjeve të punëve të një
14 ushtrie që keni miratuar në nëntor 1998, kështu?

15 "PË. Në nëntor e kam marrë këtë dokument, por dokumenti
16 ishte përpiluar më herët."

17 Ky informacion që u tha, është i saktë?

18 PË. Po. Rregulle ka pas edhe më herët, por nëntor e më tutje
19 kemi bo të tana plotësimet, ndryshimet nëpër rregulle, si
20 rregulloret e brendshme po ashtu rregulloret e tjera.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jam drejt
23 përfundimit të pyetjeve të mia. Kam edhe një pistë të fundit
24 të pyetjeve që lidhet me videon e Xhavit Halitit që pamë dje.
25 Qëndrimi ynë është ky, që është një fjali që është

1 vetëtreguese edhe prandaj videoja e djeshme duhet pranuar si e
2 plotë.

3 Nëse ju këmbëngulni që të pranohet vetëm një pjesë e asaj
4 videos, atëherë unë do t'i tregoj disa materiale të tjera
5 dëshmitarit.

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. MISETIC: [Përkthim] I qëndroj kundërshtimit të
8 djeshëm. Nëse Prokuroria kërkon të nxjerrë më shumë
9 informacione nga kjo video për të bërë të qartë qëndrimin e
10 vet, atëherë le t'ja bëjë pyetjet përkatëse dëshmitarit.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne e pamë dhe
13 vendosëm që do të pranohet e tërë videoja, e plotë pra.

14 Dhe t'i jepni numrin përkatës nëse nuk i kemi dhënë
15 numrin dje.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po, do t'i japim numrin
17 përkatës.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë
19 përfundova pyetjet e mia.

20 PY. Z. Zyrapi, faleminderit për vëmendjen tuaj.

21 Z. MISETIC: [Nuk ka përkthim].

22 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi
24 parasysh kërkesën tuaj z. Emmerson. Paraprakisht po themi që
25 po e miratojmë kërkesën tuaj veçanërisht për çështjen e

1 telefonave satelitorë. Për këtë do të lejojmë përsëritjen e
2 kundërpyetjeve.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Që të jem i qartë. Unë fillimisht
4 doja të bëja pyetje jo për telefonin por për librin që u
5 citua. S'e kisha vetëm për telefonat.

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni pyetje
7 për librin?

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, kam pyetje për librin. Po
9 jemi shumë të kushtëzuar nga koha sepse do të më duhet t'i
10 lexoj -- do të duhet t'i lexoj materialet shpejt e shpejt e të
11 përgatis pyetjet. Nëse më lejoni më jepni pak kohë. Do t'i bëj
12 pyetjet pasi të përfundojnë pyetjet e Trupit Gjykses. Pastaj
13 do të bëj kundërpyetjet e mia edhe një herë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kam më shumë pyetje. Por, nuk
15 do të përfundoj për dhjetë minuta.

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më shumë se
17 dhjetë minuta?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kam çështjen e telefonit
19 satelitor. Kam çështjen e videos sepse do t'i bëj unë pyetje
20 dëshmitarit meqë Prokurorja s'donte t'i bënte pyetje
21 dëshmitarit. Mendoj që është e drejtë që të dëgjojmë pyetjet -
22 - përgjigjet nga dëshmitari.

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë do miratoj
24 kundërpyetjet përsëritëse vetëm për telefonin satelitor sepse
25 ky është aspekti i vetëm i ri që ka dalë nga pyetjet e

1 Prokurores.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po unë kam më shumë pyetje që dua
3 të eksplorojmë.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Filloni me
5 telefonin e të shohim ku do shohim ku shkojë. Kemi probleme me
6 kohën. Kështu që përpiquni që të përfundoni sa më shpejt.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Z. Zyrapi, shkurtimisht në intervistën për ZPS-në në
10 Pjesën 14, faqja 12, ju keni thënë për ZPS-në në 2019, në
11 vitin 2019 -- ju kërkoj ndjesë. Faqja 11. Keni thënë:

12 "Nga qershori deri në nëntor [1998] kishim vetëm pajisje
13 Motorola. Ka qenë një rrjet me qark të shkurtër. Nuk kishte
14 shumë valë, domethënë, nuk kapte shumë larg.

15 "Ne kontaktet asokohe i bënim vetëm përmes korrierëve.

16 "PY. Po telefonat satelitorë?

17 "PË. Më pas. Më vonë i patëm telefonat satelitorë, nga
18 dhjetori e në vijim.

19 "PY. Pra, nga perspektiva praktike, përpara se të merrnit
20 telefonat satelitorë, ju përdornit korrierët?

21 "PË. Po."

22 E vijon pastaj dëshmia juaj.

23 "Që ta kuptoj edhe një herë z. Zyrapi. Sa kohë duhej
24 zakonisht që ta çonit ju mesazhin diku dhe ta merrnin
25 përgjigjen mbrapsht?"

1 Përgjigja juaj:

2 "Në atë kohë nuk kisha kontakte të drejtpërdrejtë me z.
3 Sylja. Në atë kohë ishte z. Krasniqi dhe të tjerë që kishin
4 kontakt të drejtpërdrejtë. Por kur dërgonim korrierin për të
5 çuar një mesazh, një porosi duheshin dy ditë të plota që ky
6 mesazh të mbërrinte në destinacion."

7 A është kjo e saktë?

8 PË. Po, e saktë është. Drejtoria operative me sa keni ju
9 dijeni, ju keni qenë epror në këtë drejtori nga qershori dhe
10 pastaj u bëtë drejtor në mes të korrikut. Keni pasur ju të
11 telefon satelitor që të komunikimit me komandën në Shqipëri?

12 PË. Jo. Jo, jo. Unë e kam cek shumë mirë edhe atëhere edhe
13 tani. Unë nuk kam pas telefon satelitor, po dhe s'kam pas
14 telefon satelitor në atë kohë. Prej qershorit deri kur jam
15 kthye nga Shqipëria, unë nuk kam pat telefon satelitor. As ka
16 pas drejtoria operative, as kam pas unë.

17 Unë qysh e kam spjegju ato atëhere qysh e kam majt
18 kontaktin, q'ashtu ka qenë. Tash a ka pas dikush tjetër që unë
19 s'e kam pa, është diçka tjetër. Nuk e di. Nuk mund të foli për
20 dikënd në qoftë se s'e kam pa.

21 PY. Të flasim tani për njësitet. Pra, jeni pjesë e drejtorisë
22 operative. Ju vetë keni dijeni të ketë pasur ndonjë njësi e
23 UÇK-së telefona satelitorë me të cilët komunikonin?

24 PË. Jo. Mu sa më kujtohet, jo. Kur kam shku unë nuk kam pa
25 une ç'a kanë pas këto njësitë kur kam vizitu ose vëzhgu që kanë

1 pas telefonat, unë s'i kam pa. Këtë periudhë prej qershorit e
2 deri kur jam kthyer prapë në Kosovë, jo.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kam edhe
4 disa pyetje të tjera të shkurtra për Xhavit Halitin dhe nëse
5 ka pasur drejtori politike.

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se sapo kemi ngarkuar një
8 dokument në listën tonë të materialeve. Nuk e di a do të na
9 lejoni ta përdorim. Është një provë materiale që e keni
10 pranuar, 1D50.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk e kundërshtojmë.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës që
15 në ekran të nxjerri provën me numër 1D50. S'e paskemi, po e
16 lexoj.

17 PY. Z. Zyrapi, do t'ju them çfarë thotë dokumenti. Është një
18 Deklaratë Politike numër 7 e 13 gushtit 1998, ku UÇK-ja bën
19 një njoftim zyrtar. Po ju lexoj paragrafin e tretë:

20 "Me synimin për të ndërprerë manipulimet që lidhen me
21 krijimin e këtyre institucioneve, Shtabi i Përgjithshëm
22 njofton publikun se Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl
23 Mahmuti, Hashim Thaçi, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota janë
24 përfaqësuesit politikë të UÇK-së. Njoftimi publik i
25 përfaqësuesve politikë të UÇK-së ndihmon për koordinimin e

1 veprimtarive politike në nivel kombëtar.”

2 A e keni ditur ju që në gusht UÇK-ja kishte bërë njoftim
3 publik dhe kishte përmendur këta persona, mes të cilëve Xhavit
4 Halitin, si përfaqësues politik të UÇK-së?

5 PË. Po, po. Në atë kohë ka qenë edhe Xhavit Haliti
6 përfaqësues politik. Kemi pas edhe në shumë shtete të tjera në
7 përfundim që kanë qenë përfaqësues politikë të UÇK-së që kanë
8 vepruar.

9 PY. Pra, kur përdor ai termin “drejtori politike” a mos e ka
10 fjalën për këta persona që UÇK-ja i kishte deklaruar
11 publikisht si përfaqësues politikë? Keni ndonjë dijeni?

12 PË. Nuk kam dijeni në ato çka ka dashtë me thonë ai me ato, po
13 drejtori politike në atë kohë nuk ka pasur, ndoshta nga
14 mendimi i tij ka mujt ato për shkak të përfaqësuesve politikë
15 që kanë qenë nëpër shtete të ndryshme të Evropës ka mujt me
16 thënë që është një farë drejtorie. Po na në strukturë unë
17 s’kam pa që ka qenë një drejtori politike ose ngatërru si
18 drejtori politike nga kjo periudhë. Folim për periudhën deri
19 nëntor, dhjetor kur u bë ristrukturimi.

20 PY. Pyetja e fundit: Këta anëtarë të drejtorisë politike, si
21 Xhavit Haliti, a mund të lëshonin urdhra për ushtarët në
22 terren, që ushtarët në terren të zbatonin urdhëresat prej
23 Shtabit të Përgjithshëm, pra mund të lëshonin urdhra?

24 PË. Jo, këta janë përfaqësues politikë, kanë qenë në shtetet
25 e ndryshme dhe ata janë marrë me çështje politike, me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 28

1 bashkësinë ndërkombëtare, me njerëz të diplomacisë për
2 çështjen Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe [E pakuptueshme]
3 për Kosovën.

4 PY. Faleminderit, z. Zyrapi.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe ju faleminderit edhe ju,
6 Kryegjykatës.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
8 ju lutem --

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në fakt e ndryshova pozicionin
10 tim edhe nuk synoj të bëj asnjë kërkesë.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, bëjmë
12 dhjetë minuta pushim tani përpara se të fillojmë me pyetjet
13 nga Trupi Gjykses.

14 Mund të dilni dhjetë minuta nga salla.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
17 minuta pushim.

18 --- Seanca ndërpritet në orën 09.55

19 --- Seanca rifillon në orën 10.05

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
21 Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi,
24 tani kemi ca pyetje nga Trupi Gjykses. Do fillojmë me
25 Gjykatësin Barthe që është në të majtën time, dhe në të

1 djathtën tuaj, z. Zyrapi.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
3 Smith.

4 Pyetje nga Trupi Gjykses:

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe mirëdita, z. Zyrapi.
6 PË. Mirëdita.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shpresoj që të më dëgjoni
8 mirë.

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Zyrapi,
11 Trupi Gjykses ka ndjekur dëshminë tuaj me shumë interes dhe me
12 shumë vëmendje gjatë dy javëve të fundit. Po ashtu kemi
13 rishikuar me kujdes transkriptin e dëshmisë tuaj dhe, ndërkohë
14 që kemi rishikuar transkriptet, kanë dalë disa çështje që ne
15 besojmë kanë nevojë për shtjellime dhe shpjegime të mëtejshme.
16 Për këtë arsye, dua që ta kaloj dëshminë tuaj në mënyrë
17 kronologjike dhe do t'ju bëj disa pyetje në mënyrë të tillë që
18 t'i jepni sqarime për të cilat ne kemi nevojë. A e kuptoni
19 këtë, z. Zyrapi?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime e
22 parë ka të bëjë me një dokument që jua ka treguar Prokuroria
23 më datë 1 korrik 2024, që ka qenë dita e parë e dëshmisë tuaj.
24 Është prova materiale P01381, dhe është ende e klasifikuar si
25 konfidenciale.

1 Z. Sekretar, nxirreni këtë provë materiale në ekran
2 përsëri pa e transmetuar për publikun.

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretari i
4 Gjykatës këshillohen]

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më thanë që dokumenti është
6 publik, kështu që mund të transmetohet për publikun.

7 Z. Zyrapi, sikurse mund ta shikoni, dokumenti ka të bëjë
8 -- ju kërkoj ndjesë, pra ka të bëjë me unifikimin e njësiveve
9 Çeliku, Lumi dhe Lisi. Dhe pyetja ime rrjedh nga faqet
10 përkatëse të transkriptit të cilat do t'i citoj. Domethënë,
11 këtë keni thënë juve më datën 1 korrik, Dëshmitar.

12 "Ne kemi diskutuar për unifikimin e këtyre njësiveve, për
13 detyrat e tyre, dhe unë kam pasur më shumë në zonën e
14 Suharekës ku kanë funksionuar njësitet Çeliku dhe Lisi. Lumi
15 ka funksionuar në territorin e Malishevës, në komunën e
16 Malishevës. Këto dy njësive janë unifikuar në zonën e
17 Suharekës në një shtab lokal që quhej shtabi lokal i
18 Suharekës. Shkurtimisht, ky ka qenë kontributi im për
19 unifikimin e këtyre njësiveve në atë kohë.

20 "PY. A keni bërë rekomandime ose propozime në Shtabin e
21 Përgjithshëm, sa i takon unifikimit të këtyre njësiveve?

22 "PË. Po, sepse unë jam dërguar atje së pari nga Sokol
23 Bashota, sepse këto dy njësive që funksiononin në atë zonë
24 kishin probleme. Ata nuk kanë qenë, nuk kanë pasur marrëdhënie
25 të mira. Kështu që për të eliminuar këto probleme dhe për të

1 unifikuar, për të bashkuar këto dy njësitate, unë kam shkuar
2 atje, kam folur me të dyja njësitet, i kemi unifikuar dhe i
3 kemi, kemi krijuar gjithashtu edhe shtabin lokal të Suharekës.

4 "Sigurisht, kur ka përfunduar kjo, kam informuar
5 drejtorinë operative për unifikimin e këtyre dy njësitiveve dhe
6 për krijimin e shtabit operativ të Suharekës, stafit lokal.

7 "PY. Po Shtabi i Përgjithshëm a e ka miratuar këtë
8 unifikim dhe propozimet e bëra prej jush?

9 "PË. Së pari, Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë quhej
10 Shtabi Qendror. Sigurisht që unë kam informuar drejtorinë
11 operative që ka qenë Sokol Bashota si shef i drejtorisë
12 operative."

13 Dhe ky është fundi i citimit tuaj.

14 Z. Zyrapi, në këtë fjalinë e fundit të kësaj pjese të
15 gjatë që unë lexova, juve thatë që keni informuar Sokol
16 Bashotën si shef i drejtorisë operative. Megjithatë, pyetja e
17 bërë nga Prokuroria ka qenë pak e ndryshme. Domethënë pyetja
18 ka qenë që a ka miratuar Shtabi i Përgjithshëm unifikimin dhe
19 propozimet e bëra prej jush?

20 Kështu që për këtë arsye dua t'jua bëj dhe një herë këtë
21 pyetje: A ka miratuar Shtabi i Përgjithshëm unifikimin dhe
22 propozimet e bëra prej jush, z. Dëshmitar?

23 PË. Unë në atë kohë e kam bërë propozimin, faktikisht, e kam
24 informuar drejtorinë operative se si është organizuar dhe si
25 është unifikuar ky shtab lokal. Pastaj, a është aprovuar a si

1 u bë, nuk e di atë, se e imja ka qenë të informoj, të raportoj
2 për atë punën që kam bërë. Se nuk kam qenë pastaj në takimet e
3 shtabit për me dit a kanë aprovuar a jo, apo dhe si e kanë
4 bërë atë punë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A ka pasur një
6 person ose ndonjë anëtar nga Shtabi Qendror, z. Bashota për
7 shembull, që është ankuar lidhur me unifikimin e këtyre
8 njësive, Dëshmitar?

9 PË. Jo, nuk është ankuar. Ai u anku më herët kur folëm për
10 ato që më ka dërguar që këto njësi mes veti nuk janë duke
11 koordinuar mirë, nuk [E pakuptueshme] me bashkëpunuar, edhe të
12 shofim se çka ka dhe si mund t'i ndihmojnë ato njësi që të
13 punojnë. Dhe si rrjedhojë e saj është edhe bashkimi i të dy
14 njësive që janë bashku së bashku dhe kanë formu shtabin lokal,
15 sikur që lexum dokumentin i cili është bo dhe është shtypur,
16 dhe ai dokument është origjinal të asaj dite e asaj kohe që
17 kanë bo. Dhe ashtu ka ndodhur.

18 Dhe pastaj veç e kemi informuar që është bërë ky shtab,
19 janë afruar të gjithë dhe kanë formuar këtë shtab. Më tutje
20 nuk ka pas ankesa nga, as z. Bashota, por as nga ndokush nga
21 shtabi.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A është e
23 saktë se njësi Çeliku më pas u transformua në Brigadën 121,
24 e stacionuar në malet e Berishës. Lumi u bë Brigada 122 e
25 stacionuar në Malishevë, dhe pastaj Lisi u transformua në

1 Brigadën 123 të stacionuar në Suharekë. A janë të sakta këto,
2 Dëshmitar?

3 PË. Po, saktë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Zyrapi,
5 pyetjet e radhës kanë të bëjnë me atë çfarë i keni thënë
6 Prokurorisë më datën 2 korrik 2024, lidhur me provën P01408.

7 Do i kërkoja Sekretarit ta paraqiste këtë provë përsëri
8 në ekran. A mund të shkojmë në faqen 2 të dokumentit? Kalojmë
9 tek faqja 2 e dokumentit.

10 Në faqen dy të këtij dokumenti, përmendet drejtoria
11 informative, ose G2, që sipas dokumentit i raporton si
12 komandantit dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm. A e shikoni
13 këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 17435 të
16 transkriptit, duke iu referuar komandantit, kur keni thënë
17 komandanti, ti ke thënë që e ke pasur fjalën si për
18 komandantin në Shqipëri dhe për komandantin në Kosovë. Por
19 kryesisht për komandantin në Kosovë sepse ai komandant i
20 merrete në mënyrë të drejtpërdrejtë raportet.

21 Përderisa kemi mësuar se ka pasur më shumë se sa një
22 zëvendëskomandant në Kosovë, në një pikë të caktuar, Trupi
23 Gjykses dëshiron të dijë se për kë komandant në Kosovë e ke
24 pasur fjalën kur ke dhënë këtë përgjigje?

25 PË. Për zëvendëskomandant, se dy zëvendëskomandantë kanë

1 qenë, dy zëvendëskomandantët në brenda, që ka në Kosovë, Jakup
2 Krasniqin edhe Sokol Bashotën.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të dy zëvendëskomandantët
4 kanë marrë raportime nga drejtorja informative, nga G2, apo
5 vetëm njëri prej tyre?

6 PË. Po tash varet prej se kujna e ka çu krejt, zëvendësit ia
7 ka dërguar tash, njonit apo dytit. Ai që ka mbajt kontaktet
8 ose takimet, te ai ma së shumti është raportuar. Kjo konkrete,
9 ma shumë, për shembull, Jakup Krasniqin.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush ka qenë komandanti në
11 Shqipëri në atë kohë? Azem Sylja?

12 PË. Azem Sylja. Për Azem Sylën folim çdo herë për në Shqipëri,
13 jashtë Kosovës.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër
15 ka të bëjë me provën P01105. Z. Zyrapi, këtë ia keni thënë
16 Prokurorisë ditën e dytë të dëshmisë dhe e keni përsëritur
17 edhe gjatë kundërpvetjeve të bëra nga Mbrojtja e z. Selimi.

18 Z. Sekretar, paraqiteni përsëri këtë provë në ekran.
19 Faleminderit.

20 Z. Zyrapi, siç mund ta shihni, ky dokument pretendohet të
21 jetë një urdhëresë nga Shtabi i Përgjithshëm i nënshkruar nga
22 zëvendëskomandanti Jakup Krasniqi, pra i jepet, domethënë
23 komandantit Drini ose urdhërohet komandanti i zonës operative
24 të Pashtrikut Drini, së bashku me komandantin e Brigadës 123,
25 dhe me Blerim Kuqin.

1 Dhe keni thënë në faqen 17446 të transkriptit, që keni
2 qenë i pranishëm vetë kur z. Kuqi ka raportuar para Shtabit të
3 Përgjithshëm dhe kur ka ardhur së bashku me komandantin e
4 zonës Ekrem Rexhën, të njohur ndryshe si komandant Drini, dhe
5 komandantin e brigadës Nexhmi Kastrati. A është e saktë kjo?
6 PË. Po.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më tej na keni
8 thënë se nga çfarë ju kujtohet, kur kanë ardhur të tre,
9 komandanti Drini ka ardhur, ka shkuar me juve te drejtoria
10 operative dhe keni diskutuar për çështje operative aty,
11 ndërkohë që Nexhmi Kastrati ka shkuar në Brigadën 121 për të
12 diskutuar çështjet përkatëse ndërkohë që Blerim Kuqi ka
13 qëndruar te komanda. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
14 PË. Po, e saktë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në komandë, së bashku me
16 Blerim Kuqin, ju thoni që ka qenë Jakup Krasniqi, Rexhep
17 Selimi dhe Fatmir Limaj. A është e saktë kjo?
18 PË. Po, ashtu.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, nga e dini ju që
20 Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Fatmir Limaj kanë qenë në
21 komandë me Blerim Kuqin? I ke parë vetë me sytë e tu ti ata?
22 PË. Po unë kur e ceka që kam qenë edhe unë në takim kur kanë
23 ardhur, se ne kemi qenë në takim bashkë. Unë kam dalë me
24 Drinin kurse këta kanë mbetur brenda me Blerim Kuqin. Nga ky
25 aspekt edhe e them, e vërtetoj.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptojmë. Prokurorja ju
2 pyeti me datë 2 korrik 2024, dhe këtu citoj:

3 "A ka pasur ndonjë vendim për të ndaluar Blerim Kuqin?"
4 Dhe këtu përfundon citimi.

5 Përgjigja juaj pastaj vijon në faqen 17447 të
6 transkriptit. Dhe këtu citoj:

7 "Po, pas kësaj u mor vendimi për ta ndaluar atë."
8 Dhe prapë këtu e përfundoj citimin.

9 Më 10 korrik ju bëri pyetje Avokati i z. Selimi për të
10 konfirmuar se ju nuk e dini se kush e ka nxjerrë vendimin, dhe
11 jeni përgjigjur kësaj pyetje në faqen 17987 të transkriptit si
12 më poshtë:

13 "Në atë moment, nuk e dija."

14 Tani, z. Zyrapi, Trupi Gjykses dëshiron të dijë prej jush
15 se kush e ka marrë vendimin që kishte të bënte me ndalimin e
16 Blerim Kuqit. Ju keni thënë që nuk e dini se kush e ka nxjerrë
17 vendimin. A e dini? E para. Dhe së dyti, ju lutem, na thoni
18 kush e ka nxjerrë vendimin për ndalimin e Blerim Kuqit?

19 PË. Së pari, nuk e di saktë kush e ka nxjerrë vendimin, e di
20 që është marrë vendimi dhe është ndal Blerim Kuqi. Më mirë e
21 dinë ata kush kanë qenë aty që kanë marrë atë vendim. Se nuk
22 kam qenë në atë kohë aty brenda kur është marrë ky vendim ose
23 është shkrujt ky vendim.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Vendimi është marrë gjatë
25 takimit në komandë, me aq sa dini ju? Pra, vendimi është marrë

1 nga këta tre individë që ishin së bashku me Blerim Kuqin, pra
2 nga këta persona? Që është, tre personat që përmenda më
3 përpara bashkë me Blerim Kuqin.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj që
5 dëshmitari tha që është larguar nga takimi, kështu që nuk
6 është në gjendje që t'i përgjigjet pyetjes së bërë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 vazhdoni përgjigjuni pyetjes, Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Nuk muj ta di prej tyre kush e ka dhanë. Ata
10 kanë qenë aty në atë takim, kush prej tyre ka dhanë, nuk e di.
11 Se s'kam qenë aty me pa. Veç e di që vendimi është dhanë, dhe
12 është burgosur.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, më 10 qershor --
14 10 korrik, më falni, ju thoni që vendimi është marrë të
15 njëjtën datë, që është 16 janari 1999. A është e saktë kjo?
16 PË. Po, e ceka dhe më herët. Në q'atë ditë. Në q'atë ditë
17 është marrë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do ju pyes dhe një herë. Nga
19 e dini ju që vendimi për ndalimin e z. Kuqi është nxjerrë të
20 njëjtën ditë, pra më 16 janar? Nga e dini këtë gjë.

21 PË. E di që në q'atë ditë menjëherë është burgosur z. Kuqi.
22 Simbas saj.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, dëshmia juaj është që
24 z. Kuqi është arrestuar dhe është burgosur atë ditë,
25 domethënë, më 16 janar 1999?

1 PË. Po, në atë ditë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e dini ju këtë? E keni
3 parë, vetë, e keni dëgjuar nga dikush? Nga e dini?

4 PË. Po, në atë kohë tash unë mbasi u marrë ky vendim, mbasi
5 kam përfundu me komandant Drinin, se iu ka kumtu edhe
6 komandant Drinit që ai është arrestuar. Dhe prej asaj dite e
7 di nga vetë, domethënë, kur e kam pyet Jakup Krasniqin, po,
8 është marrë kjo masë, dhe është në -- gjindet në, është
9 arrestuar. Vendimin nuk e di, nuk e kam pa, se kush, si e ka
10 marrë prej -- kush e ka marrë prej tyre, nuk e di.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj se
12 është e qartë tani.

13 Pyetjet e mia të radhës kanë të bëjnë me një provë
14 tjetër, që u përdor nga marrja në pyetje nga Prokuroria.
15 Përkatesisht pyetjet lidhen me provën P01414 ose ndryshe
16 SPOE00228820.

17 Do i lutesha Sekretarit ta paraqiste këtë provë.
18 Faleminderit.

19 Z. Zyrapi, më datë 2 korrik 2024, ju konfirmoni në faqen
20 17457 të transkriptit që e njihni vulën dhe nënshkrimin në
21 këtë dokument. Pra, thoni që vula është ajo e Shtabit të
22 Përgjithshëm dhe nënshkrimi është ajo e Jakup Krasniqit. Ju
23 thoni më tej gjithashtu që ju kujtohet, pak a shumë, urdhrin
24 për ndalimin e përdorimit të maskave, a është e saktë kjo?

25 PË. Po, saktë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thoni gjithashtu që asokohe
2 disa njerëz paraqiteshin me maska dhe për këtë arsye doli ky
3 urdhri për të ndaluar përdorimin e maskave, dhe që ju ishit në
4 dijeni lidhur me këtë sepse kishit marrë ankesa nga zonat
5 operative lidhur me njerëz ose ushtarë që vishnin maska. A
6 është e saktë kjo?

7 PË. Po, e saktë është.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dua t'ju pyes si më poshtë:
9 E para, kush është ankuar konkretisht se njerëzit vinin maska?
10 Këto ankesa kanë ardhur nga zonat operative?

11 PË. Po, ka pas nga zona operative, këtu është ka marrë edhe e
12 Drenicës, edhe e Pashtrikut, edhe e Shalës. Në atë kohë kemi
13 pas këto ankesa, sa më kujtohet mu, të asaj kohe.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga komandantët e zonave?

15 PË. Nga komandantët e zonave, po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në çfarë forme janë dorëzuar
17 këto ankesa, në formë të shkruar, me gojë?

18 PË. Jo, këto janë grumbullu me gojë kur, gjatë takimeve.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë takimeve me Shtabin e
20 Përgjithshëm, anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, dhe
21 komandantë të zonave operative?

22 PË. Po, më kujtohet më shumë ka qenë edhe gjatë vizitave të
23 mia nëpër zona, por edhe gjatë takimeve me komandantët.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na shpjegoni se
25 pse ishte problem që njerëzit ose ushtarët vinin maska, ishin

1 me maska, pse ishte problem kjo?

2 PË. Po ishte problem për arsye se të shumtët ata që përdornin
3 maskat për mos u njoft, identifikuar, vepronin në territoret e
4 zonave të cilat nuk ishin ushtarët e tyre, ose nuk kishin
5 urdhra të tilla për të marrë ose që kanë vepruar me civilët
6 apo me marrjen e mjeteve materiale apo ndalimin e personave në
7 atë zonë. Ky ishte problem se nuk e dishte se kush ishin ata
8 që po e ndalin atë. Kush janë këta që kanë vendos këto maska
9 dhe po bëjnë këto veprime? Nuk ishin ushtarët e këtyne zonave.
10 Për atë edhe komandantët e zonave janë ankuar. Për këtë, dhe
11 është marrë ky vendim.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ky urdhër me sa dini ju, a
13 është zbatuar, është ndjekur?

14 PË. Është dërguar nëpër zonat, të gjitha, sa e kanë ndjek ma
15 tutje nuk e di saktë, edhe pse shumë urdhra kemi dhanë, por
16 nuk i kanë ndjek të gjitha komandantët e zonave.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur ende ankesa pasi
18 doli ky urdhër dhe u dërgua tek zonat operative, pra, pas
19 janarit të 1999?

20 PË. Nëse më kujtohet, jo, nuk kemi pasur kështu, domethënë,
21 nuk ka pas këto veprime.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e
23 radhës lidhen me ditën e tretë të dëshmisë suaj këtu,
24 përkatësisht 3 korrik 2024.

25 I lutem Sekretarit të Seancës të vendosë në ekran provën

1 materiale P00633. Faleminderit.

2 Siç mund ta shihni, z. Zyrapi, dokumenti mban datën 12
3 shkurt 1999, dhe ndër të tjera flitet dhe për emërimin e Sali
4 Veselit si ushtrues i detyrës së komandantit të zonës
5 operative të Pashtrikut.

6 Ju, lidhur me këtë dokument, shpjeguat se nuk ishte
7 detyrë e juaj, si shef shtabi, të emëronit komandantët e
8 zonave të brigadave, të batalioneve. Ju thatë:

9 "Komandantët e batalioneve dhe eprorët në zona nuk
10 emëroheshin nga komandantët apo shefi i shtabit të
11 përgjithshëm. Por emëroheshin nga vetë komandantët e zonave".

12 Kështu?

13 PË. Po, saktë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më tej shtuat se nuk deshët
15 të nënshkruanit apo të pajtoheshit me ndryshimet, pra të
16 nënshkruanit dokumentin për emërimet dhe për zëvendësime në
17 zonën e Pashtrikut sepse, A. nuk donit të ndryshohet
18 komandanti i zonës për arsye profesionale, dhe B. nuk ishte
19 kompetencë e juaja të zëvendësonit një komandant zone. A ju
20 kujtohet ta keni thënë këtë?

21 PË. Po, saktë. Ashtu është.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal i referohem
23 faqeve 17497, deri në 17499 të transkriptit.

24 Z. Zyrapi, Trupi Gjykses dëshiron të dijë kush e ka pasur
25 kompetencë brenda UÇK-së të zëvendësonte një komandant zone?

1 PË. Po. Komandantin e zonës për ta zëvendësuar ka pas të
2 drejtë veç komandanti i përgjithshëm. Në qoftë se normalisht
3 propozohet edhe nga shefi i shtabit, për të ndryshuar ai
4 komandant. Për cilat janë arsyet kur të jipet një zëvendësim?
5 Në qoftë se ai nuk e kryen detyrën e vet, nuk është i aftë të
6 komandojë me njësitë operative, nuk është i aftë të udhëheqë
7 atë njësi, atëherë mund të shkohet te ndryshimi i komandantit
8 të zonës. Por në qoftë se ai i ka të gjitha dhe i vepron dhe
9 punon, atëherë nuk ka nevojë të ndryshohet.

10 Për atë dhe në këtë kontekst, nuk kam shkuar që të, nuk
11 kam -- jam pajtuar që të ndërrohet i zonës. Kurse vendosjen e
12 tij apert e bën komandanti i shtabit. Shtabi, propozohet nga
13 shefi i shtabit, aprovohet, apo jo nga komandanti i
14 përgjithshëm. Te komandanti i zonës. Kurse të tjerët
15 propozohen nga vetë komandanti i zonës, zëvendëskomandantët
16 propozohen nga komandanti i zonës, emërohen nga Shtabi i
17 Përgjithshëm.

18 Është, domethënë, drejtoria e personelit e cila e
19 përgatit dokumentin dhe jep arsyet pse vendoset ai, zëvendës
20 aty dhe komandanti i përgjithshëm ose zëvendës i tij nënshkruan
21 dokumentin për emërimin e tij në atë pozitë.

22 Të tjerët të gjithë i emëron komandanti i zonës brenda
23 zonës së vet se vetë i propozon ato edhe i vendos. Komandantët
24 e brigadave kanë qenë të propozuar nga komandanti i zonës, të
25 emëruar nga Shtabi i Përgjithshëm. Të gjithë të tjerët në

1 kuadër të brigadës janë emëru, propozuar e emëruar nga
2 komandanti i zonës. Komandantët e batalioneve nga komandanti i
3 zonës. Propozohen nga komandanti i brigadës, aprovohen nga
4 komandanti i zonës. Këto janë arsyt.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. T'i kthehem
6 pyetjes fillestare që pata, për zëvendësimin e komandantëve të
7 zonave. Në Shtabin e Përgjithshëm, a kishte persona që ishin
8 të përfshirë në një vendim të tillë, pra për zëvendësim, dhe
9 nëse po, si kryhej kjo? Pra, përpara se një komandant i
10 përgjithshëm të zëvendësonte një komandant zone, apo të merrte
11 vendim për zëvendësimin e një komandanti zone, a bëhej ndonjë
12 takim paraprakisht, për shembull?

13 PË. Për këto kemi pas një takim, me anë të, si shtab.
14 Domethënë në atë kohë në atë takim unë kam refuzuar që të
15 ndërrohet. Mirëpo, në kuadër të shtabit, domethënë, është
16 komisioni kuadrovik i cili analizon dhe bie në një vendim të
17 tillë që mund të, një propozim që mund të jepet për ndryshimin
18 e komandantit të zonës apo ndonjë eprori që i jepet
19 komandantit të përgjithshëm që ai të vendosë ndërrimin apo
20 mosndërrimin e tij.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, kush i propozonte
22 emërimet e këtyre personave që po shohim në këtë provë? Këto
23 propozime kanë ardhur vetë nga zona operative e Pashtrikut?

24 PË. Nuk e di prej kujt kanë ardh këto, kush i ka bo këto,
25 autori i saj duhet me e dit prej kujt i kanë ardh këto dhe si

1 e kanë bo.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jemi të qartë për këtë
3 pikë. Këta persona që po shohim në dokument, p.sh. Sali
4 Veseli, a u bë në fakt ushtrues i detyrës në shkurt të 1999?
5 Besoj që e keni thënë një herë jo, por mund ta thoni dhe një
6 herë, ju lutem?

7 PË. Jo, nuk është bë asnjherë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për çfarë arsye? Pse nuk
9 ndodhi? Sepse nuk deshët ju ta nënshkruanit dokumentin, apo u
10 refuzuan propozimet nga komandanti i përgjithshëm? Pra, cila
11 qe arsyeja?

12 PË. Arsyeja ishte që, së pari, këtë dokument nuk e kam pa ma
13 herët, dhe në atë kohë nuk më është tregu ky dokument. As m'u
14 ofru për nënshkrim. Në atë kohë kur kemi bisedu është çështja
15 e komandantit që unë e kam refuzuar që të ndryshohen. Për
16 gjëra të tjera është dasht t'i kryejë komandanti i zonës, dhe
17 këto propozime, por nuk është bërë. Nuk është bërë për arsye
18 se unë nuk kam, nuk jam pajtuar me atë punë. Edhe normalisht
19 që komandanti i përgjithshëm në atë kohë nuk ende, nuk ka
20 marrë vendim.

21 Se edhe së pakti, faktikisht, edhe periudha kur është bë
22 kjo në këtë kohë, komandanti i përgjithshëm ka qenë jashtë,
23 zëvendësi ka qenë brenda normalisht, dhe kemi filluar atë
24 procedurën kur ishte edhe zëvendësimi i komandantit të
25 përgjithshëm që shifet edhe simbas takimeve të mëvonshme me

1 komandantët e zonave. Kështu që kjo nuk është bë ky ndryshim.
2 Së pari, unë që e kam refuzuar që të ndërrohet ky ndërrim,
3 edhe i dyti që komandanti nuk ka qenë prezent, dhe ata e kryen
4 menjëherë këtë veprimin, këto, këtë datë, ose këtë kohë, o ma
5 vonë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, kemi dëgjuar për
7 zëvendësimin e komandant Drinit në pranverë të 1999. A mund të
8 na shpjegoni shkurtimisht nga pikëpamja teknike si, çfarë
9 procesi ndodhi? Nuk më interesojnë arsyet --
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- por hapat që u ndoqën, më
12 përshkruani çfarë procedure u ndoq për zëvendësimin e Drinit?
13 PË. Po, as nuk e di, po ashtu tash procedurën është dasht,
14 komisioni kuadrovik që ka qenë, ka dhanë komandantit të
15 përgjithshëm. Komandant i përgjithshëm faktikisht në atë kohë
16 që e ka marrë këtë vendim të zëvendësimit ka qenë, e marrë
17 komandën, e ka marrë Sylejman Selimi, si komandant i
18 përgjithshëm. Dhe ai ka marrë në atë kohë, ka nënshkru atë
19 vendimin e ndryshimit të komandant Drinit si komandant i zonës
20 me Tahir Sinanin që ka qenë, është zëvendësu, që ka zëvendësu
21 Drinin në atë kohë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të dija
23 arsyet, për ç'arsye u zëvendësua komandant Drini dhe pse u
24 emërua Tahir sinani në vend të tij?

25 PË. Po e ka zëvendësuar se në atë kohë faktikisht nonstop

1 është kërkuar që të largohet komandant Drini nga kjo pozitë,
2 dhe për arsye të ndryshimit është, faktikisht, tanë kohën si e
3 shifni dhe takimet që janë mbajtur kërkuar nga Rexhep Selimi
4 nonstop që të largohet komandant Drini nga kjo pozitë dhe të
5 zëvendësohet me tjetrin.

6 Kjo ishte arsyeja, domethënë, që kanë dhanë në atë kohë
7 dhe sipas tyre disa raporte që janë dhanë nga zona që unë s'i
8 kam pa në atë kohë. Por tek më vonë i kam pa këto raportet, që
9 nga ana jem, me i kqyr këto raportet. Edhe ato që mund ta
10 përcjellim nuk është arsye e tillë, që bash ashtu është si që
11 është prezentu në raporte.

12 Edhe është pru ky vendim edhe e kanë zëvendësu.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur ankesa për
14 performancën ushtarake të komandant Drinit, apo çfarë arsye
15 kishte? Pse e kërkuan zëvendësimin e tij?

16 PË. Jo, nuk ishte nga aspektet ushtarake ose pjesën
17 profesionale, ma shumë ka qenë ato që, faktikisht, folin që
18 grupi i cili ka ardhur në nëntor i eprorëve dhe që kemi
19 shpërnda në Brigadën 123 dhe në zonën e Pashtrikut, kanë ardhë
20 me marrëveshje që e kemi bo me ministrinë e Bukoshit. Dhe të
21 cilën i kanë krahasuar si pjesë të FARK-ut, që nuk ishte
22 ashtu, se ata ishin të gjithë të Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës. Dhe në atë moment kur ata kanë nënshkru marrëveshjen
24 dhe i kanë hy, se pranimit që janë nën komandën e Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm, nuk mund të

1 thuhet që një informacion tjetër dhe as kanë pas shenja të
2 tilla.

3 Është që vërtet ata kanë tentuar çdo herë, kjo pjesa e
4 Bukoshit, që t'i bën me dokumentacionet e ndryshme, po ato
5 kemi zgjidhur me di, herën, me ardhjen e tyre në fillim. Edhe
6 me atëherë ministrin Halil Bicaj. Dhe këta djemtë janë
7 renditur nëpër këto njësi, nën udhëheqjen ose komandimin e
8 tyre, dhe kanë vepruar sipas urdhrave të Shtabit të
9 Përgjithshëm dhe shtabeve, komandantëve të zonave, dhe Shtabi
10 i Përgjithshëm dhe normalisht që nuk ka pas ndonjë ndikim
11 tjetër ushtarak.

12 Dhe nga ky aspekt këta, është bërë edhe ai raport dhe është
13 drejtu kështu që është fajtor komandant Drini që po
14 bashkëpunon me atë drejtim, që nuk ishte ashtu, edhe ishte
15 krejt e kundërta se ne, komandanti ka nën udhëheqje këto
16 gjithë ata grupe të njësive, eprorëve, janë eprorë të njëjtë.
17 Pa marrë parasysh se kush ka qenë para [E pakuptueshme]
18 partiake, këto nuk kanë qenë në atë kohë. Ato çdo njëni ka të
19 drejtën e vet të aspektit politik, por të merret jashtë
20 aspektit profesional dhe ato mbas luftës.

21 Kështu që, këto ishin arsyt që ata tentoshin që nuk
22 ishte, për mua nuk ishte arsye aspak, se aspak nuk është shku
23 në atë drejtim që punohet. Dhe kjo ishte arsyeja që erdhi, ka
24 ardh deri te ndërrimi i komandantit të zonës.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Që të jemi të

1 qartë për këtë pjesë, u mor, u konsiderua, më falni, a
2 konsiderohej dhe komandant Drini si pjesë e FARK-ut, si pjesë
3 e FARK-ut, po?
4 PË. Faktikisht, në atë raportin dje kur e lexum të z.
5 Halitjaha, Halil Qadrakut, jo vetëm ata që i bënë pjesë te
6 FARK-u, por edhe mua si shef shtabi që isha në atë kohë. Jo
7 vetëm aty, por dhe sot, dhe sot e qe 25 vite vazhdojnë në
8 mediat hapura këta zotërinjtë thërrasin njëjtë. Këta e
9 konsiderojnë njëjtë si pjesë e FARK-ut. Që të gjitha prej
10 pamjes kyçja ime edhe e komandant Drinit ka qenë kundër të
11 asaj çka ata e thojnë. Gjithnjë lidhja jonë ka qenë me
12 ushtarët, me pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur
13 ta marrin Drini ka qenë një ndër pjesët, i afërmjet parëve të
14 njërive të atë kohe, në qoftë se marrim, ka qenë i kyçur, çka
15 di, në njësitin Çeliku, në bjeshkën e Kabashit në Prizren.
16 Qysh kur kam ardh e kam gjet në atë njësi që veç ka qenë i
17 veshur në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Dhe si mund të jetë
18 i FARK-ut i rekrutuar ose i ministrisë në ekzil e cila është?
19 Kështu që kjo është aspekti që këta zotërinjtë na kanë
20 qujt, dhe na qujn hala.
21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Për pyetjet e
22 radhës, do të doja të ktheheshim pas në kohë dhe të flasim, të
23 flasim për mbërritjen tuaj në Kosovë, në maj të 1998 gjatë
24 luftës. Kështu ka qenë, maj 1998, apo jo?
25 PË. Po, maj 1998.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju, gjatë kundërpvetjeve nga
2 Mbrojtja e Thaçit, konfirmuat se keni hyrë në Kosovë bashkë me
3 Agim Qelaj, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Adem Grabovcin,
4 kështu?

5 PË. Po, edhe të tjerë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe të tjerë, po. Për
7 procesverbal kjo është në faqet 17547 dhe 8 të transkriptit.

8 Z. Zyrapi, kur hytë në Kosovë me z. Thaçi dhe z. Veseli,
9 çfarë kishin veshur këta të dy? A kishin uniforma apo kishin
10 rroba civile, tesha civile?

11 PË. Po çka më kujtohet të gjithë kemi qenë me tesha, me
12 uniformë. Komplet grupi kemi qenë të uniformuar. Përveçse disa
13 që kanë qenë me tesha, rroba civile, ata që kanë transportuar
14 armët dhe kanë qenë të ngarkum me municione dhe armë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo do të kishte qenë në
16 fakt pyetja ime e radhës. Z. Thaçi dhe z. Veseli a kishin armë
17 kur hynë me ju në Kosovë, dhe nëse po, çfarë arme?

18 PË. Të gjithë grupi i kemi pasë armët. Çdonjëni kemi pas nga
19 një armë personale, zakonisht kemi pas armën kallashnikov, A-
20 47. Përgjithësi, domethënë, sa i përket neve, edhe unë vetë
21 edhe z. Thaçi dhe z. Veseli, njëjtë e kanë pas, edhe anëtarët
22 e tjerë. Përveç saj kemi pas edhe nga një armë shtesë, kemi
23 bajtur, për të shtyrë brenda, dhe për njerëz brenda që janë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më pas kur u takuat me z.
25 Thaçi dhe z. Veseli, gjatë luftës, çfarë kishin veshur dhe a

1 kishin armë me sa kujtoni ju?

2 PË. Po në, varësish prej situatave, nganjëherë ishte me
3 uniformë, nganjëherë ishte me rroba civile, në varësisht prej
4 atyre veprimeve, nganjëherë mban armë të gjata, nganjëherë jo.
5 Jo vetëm ata, por edhe unë, njëjtë. Varësisht prej veprimit të
6 lëvizjes së, që kemi pasur.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do t'ju
8 pyes për rolin e z. Thaçi apo funksionin në Shtabin e
9 Përgjithshëm sipas asaj që kishit kuptuar ju.

10 Më 3 korrik 2024, na thatë që z. Thaçi mbulonte median
11 dhe drejtorinë për marrëdhënien me publikun në qershor të
12 1998, dhe kishte pozitën e drejtorit për median dhe
13 komunikimin deri në, deri në nëntor të 1998. Ose më saktë deri
14 në momentin që u bë përfaqësues politik i UÇK-së, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më tej, keni thënë se z.
17 Thaçi u emërua si përfaqësues politik i UÇK-së për shkak të
18 përvojave të mëparshme me publikun dhe me median, dhe se e
19 njihte dhe aspektin ndërkombëtar. Ju thatë që ai u caktua për
20 të kryer këto detyra, dhe ai i ushtroi këto detyra deri në
21 momentin e Rambujesë pas së cilës u bë kryeministër i qeverisë
22 së përkohshme të Kosovës, saktë?

23 PË. Po, saktë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të dija
25 këtë. Saktësisht, çfarë detyrash kishte z. Thaçi si drejtor

1 për median dhe komunikimin? Me fjalë të tjera çfarë bënte ai
2 në atë kohë nëse e dini?

3 PË. Po çka muj me ditë, në atë kohë, unë çka mund me pa është
4 çështja që ka pas me mediat, por dhe me ndërkombëtarët. Dhe
5 marrëdhëniet, domethënë, bisedat me njerëz diplomatë. Po ashtu
6 edhe ka pas kontakte dhe me këta përfaqësues politikë që kanë
7 qenë nëpër shtetet e ndryshme të Perëndimit.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju e keni parë personalisht
9 të fliste me gazetarët kur keni qenë bashkë?

10 PË. Jo, personalisht jo. Nuk...

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi ka dhënë intervista
12 në televizione në atë kohë?

13 PË. Nuk e di, nuk e di për atë kohë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tjetër, çfarë ka bërë z.
15 Thaçi përveçse që ka qenë drejtor për komunikimin dhe për
16 median, apo ka qenë si të thuash një detyrë me kohë të plotë,
17 24 orë të ditës?

18 PË. Po ajo të gjithë [E padëgjueshme] kanë qenë me ditë të
19 plotë 24 orë detyrat tona. Por çka i përket asaj është marrë
20 dhe vetë me mediat, por edhe me, thashë, me përfaqësues
21 politikë që kanë qenë dhe jashtë për Evropë ose perëndim. Dhe
22 është marrur edhe me bisedimet të cilat kanë ndodh me --
23 diplomatë të huaj, në atë kohë. Nëse më kujtohet, ashtu kam
24 mujt ta shoh edhe ta di.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa dini ju, a ka qenë

1 edhe përgjegjës për të bashkëpunuar me zëdhënësin e UÇK-së sa
2 i takon përpilimit dhe publikimit të komunikatave,
3 komunikatave apo deklaratave politike të UÇK-së apo dokumente
4 të tjera të UÇK-së?

5 PË. Jo, nuk e di për atë. Se s'kam pas qasje në atë drejtim.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk e dini kush ka
7 qenë përgjegjës për përgatitjen e deklaratave zyrtare të UÇK-
8 së?

9 PË. Jo, jo, nuk e di.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Zyrapi, kam dhe një pyetje tjetër për rolin e z. Thaçi
12 si përfaqësues politik i UÇK-së përpara se të bëhej
13 kryeministër i qeverisë së përkohshme të Kosovës.

14 Kemi dëgjuar disa herë se Adem Demaçi ka qëndruar në
15 Prishtinë gjatë luftës dhe se ka qenë përfaqësues politik i
16 UÇK-së, a është e saktë kjo?

17 PË. Po, e saktë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, unë tani dua të di
19 çfarë dallimi kishte roli i Adem Demaçit nga ai i Hashim
20 Thaçit kur të dy ishin përfaqësues politikë të UÇK-së?

21 PË. Po roli, e ceka edhe vetë edhe më herët, Hashim Thaçi u
22 përcaktu domethënë brenda [E pakuptueshme] do të jetë është në
23 drejtorinë operative -- në drejtorinë politike, e cila
24 ekskluzive ka qenë për bisedat me ndërkombëtarët, për ato që e
25 ka pas, edhe thashë, e ceka më herët, dhe përvojën. Kurse Adem

1 Demaçi normalisht e ka pas me opinionin në tërësi që është
2 marrë edhe ka kry këtë detyrë. Për q'atë edhe detyrat janë,
3 kanë qenë të ndryshme.

4 Se kur folim për Hashim Thaçin, domethënë, është pjesa e
5 tij që është përcaktu se në q'atë periudhë ne kemi fillue veç
6 pak dhe ma herët se të fillohet diskutimi, edhe ndërkombëtarët
7 të cilët kanë qenë brenda në, si vëzhgues, dhe ata që kanë
8 ardh të bisedojnë, është dashtë të drejtohet diku, dhe është
9 drejtue kjo drejtori faktikisht me Hashim Thaçin. Ndoshta ka
10 pas edhe me Adem Demaçin, por nuk e di unë ato, dhe si kanë
11 shku dhe si janë koordinu këto punë mes vete, nuk e di. Se nuk
12 kam përcjell më tutje këtë pjesën e politikës.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi apo z. Demaçi,
14 ishte ndonjëri, pra, nga këta të dy epror ndaj njëri-tjetrit
15 dhe nëse po, kush ishte eprori i kujt, midis këtyre dy
16 personave?

17 PË. Nuk e di kush muj me qenë eprori se përfaqësuesit
18 politikë kanë qenë përfaqësues politikë. Ai eprori i gjithë
19 tyne me u kanë veç komanda e Shtabit të Përgjithshëm. Por
20 epror njëri-tjetrin, nuk e di për atë punë, dhe kush ka mujt
21 me qenë. Sistemin organizativ në atë drejtim nuk jam marrë dhe
22 nuk e di.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Përpara
24 pushimit, në orën 11.00 do të bëj disa pyetje për një temë
25 tjetër. I lutem Sekretarit të Seancës të vendosë në ekran

1 materialin P0178. Është një video, ndërsa transkripti ka
2 numrin 061427-27-TR-ET. Nuk është nevoja ta shohim videon.

3 [Mikrofoni çaktivizuar] -- kërkuar të përsëris numrin e
4 provës materiale. P01278.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, më thoni nëse
6 doni ta shihni videon apo jo?

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo. Jo, nuk është nevoja ta
8 shohim videon. Më duhen imazhet e ngrira të videos.

9 Z. Zyrapi, a ju kujtohet që e patë këtë video javën e
10 parë të dëshmisë suaj?

11 PË. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sipas përkthimit në anglisht
13 të videos, ju keni thënë ndër të tjera kështu, është pjesë e
14 materialit 061427-27-TR-ET. Ju keni thënë:

15 "Gjatë aftësimin të ushtarëve dhe oficerëve, u habitëm
16 nga aftësia dhe shpejtësia se si ushtarët dhe oficerët e
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra sa shpejt u përgatitën dhe
18 ishin në gjendje të plotësonin nevojat e UÇK-së dhe nevojat që
19 lidhen me betejat dhe luftimet nëpër territorin e Kosovës."

20 Z. Zyrapi, ju konfirmuat në, gjatë një pyetjeje që ju
21 bëri -- ekipi i z. Thaçi, ju keni thënë që kjo video është
22 incizuar për qëllime propagandiste.

23 Tani do ju pyes, edhe kjo pjesë që ju lexova unë ju, për
24 qëllime propagandiste u përgatit? Me fjalë të tjera, ju vërtet
25 u habitët apo nuk u habitët me aftësinë dhe shpejtësinë e

1 përgatitjes së ushtarëve dhe oficerëve sa u takon plotësimin
2 të nevojave të UÇK-së për luftë e betejë? Pra, kjo ishte
3 propagandë apo vërtet ju u habitët me aftësitë e tyre?
4 PË. Së pari është, video ka qenë pjesë e propagandës. Qysh në
5 fillim me thanë në pjesën e çuditshme ka edhe pjesë të
6 çuditshme që ka qenë disa elemente të cilat kanë mujt t'i
7 mësojnë q'aq shpejt, por dhe shumë të tjera që s'i kanë ditur.
8 Po ma e shumti është, në aspektin kur folim këtu, është më
9 shumë aspekt propagande për të treguar që shumë shpejt po
10 mësojnë edhe shumë shpejt janë, domethënë, po aftësohen. Por
11 nuk ishte aq e plotë dhe ma shumë propagandistike.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit për këtë. A
13 kam kuptuar drejt dëshminë tuaj kur thoni se ju në fakt nuk
14 ishit të bindur se këta ushtarë vërtet i kishin aftësitë që u
15 nevojiteshin për luftime kundër armikut në atë kohë?

16 PË. Po, e saktë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
19 pushimin e paradites, Dëshmitar. Mund të largoheni nga salla e
20 gjyqit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
23 orën 11.30.

24 --- Pauza fillon në orën 11.03

25 --- Seanca rifillon në orën 11.31

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 silleni dëshmitarin në sallë.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi, do
5 të vazhdojmë tani me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit dhe mirë se
7 erdhe, z. Zyrapi.

8 PË. Ju faleminderit dhe mirë se ju gjej.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje tjetër në
10 lidhje me Shtabin e Përgjithshëm. Na keni thënë më datën 3
11 korrik 2024 që Shtabi i Përgjithshëm nuk e ka dhënë dritën
12 jeshile për të vazhduar më tej me sulmin në Rahovec sepse kjo,
13 siç keni thënë juve, do të kërkonte më shumë kohë dhe më shumë
14 pajisje përgatitore dhe njësi për të kryes një sulm të tillë
15 në zona të banuara nga civilët. Pavarësisht, komandanti i
16 njësitit lokal kreu një operacion pa ju pyetur juve dhe
17 Shtabin e Përgjithshëm e përgjithshëm, u fut në Rahovec dhe
18 kreu një sulm i cili përfundoi në pasoja negative për UÇK-në.

19 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, z. Zyrapi?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, kjo mund
22 të gjendet në numrin 17585 të transkriptit.

23 Z. Zyrapi, një ditë më pas, më 4 korrik 2024, në faqen
24 17629 të transkriptit ju pyeti Avokati i z. Thaçi lidhur me
25 një incident në dhjetor të 1998 që përfshinte komandant Remin

1 në Podujevë dhe ju u pajtuat me avokatin Misetiq që komandanti
2 Remi nuk i dëgjonte kërkesat e Shtabit të Përgjithshëm,
3 domethënë, drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm për
4 të tërhequr forcat nga fronti i Podujevës. A pajtoheni me
5 këtë, Dëshmitar, a ju kujtohet kjo?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e parë në këtë
8 kontekst është si më poshtë: Drejtoria operative e Shtabit të
9 Përgjithshëm i ka dhënë komandantit Remi një urdhër të
10 drejtpërdrejt për të tërhequr forcat e veta nga fronti i
11 Podujevës?

12 PË. Sa më kujtohet, po.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush ia ka dhënë atij
14 urdhrin?

15 PË. Unë, s'më kujtohet në atë kohë, unë e kam bisedu me
16 zëvendëskomandantin e zonës së operative, që e kam pas
17 këshilluar që të largohet ose të ndalet në atë drejtim, të mos
18 të shkon në drejtim të luftimeve. Për tjetrën të Remit nuk e
19 di, unë nuk kam pas kontakt me të drejtpërdrejt në atë kohë,
20 po me zëvendëskomandantin po. Folim për mua, për të tjerët nuk
21 e di kush ka qenë tjetër.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, si ish-
23 profesionist ushtarak, ju me siguri e dini dallimin midis një
24 urdhri dhe këshille. Kështu që do t'jua bëj dhe një herë
25 pyetjen. A i keni dhënë zëvendëskomandantit ju një urdhër apo

1 thjesht e keni këshilluar atë që të tërhiqte forcat nga fronti
2 i Podujevës?

3 PË. Po në atë kohë ka qenë si lloj këshille.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo si një lloj këshille
5 ishte e detyrueshme për zbatim nga komandant Remi? Domethënë,
6 me fjalë të tjera, komandant Remi e kishte në dorë ai vetë,
7 domethënë, që ta ndiqte ose jo urdhrin apo ishte e detyrueshme
8 që ta zbatonte këtë këshillë tuajën?

9 PË. Po ai ka pas në dorë drejt për situatën e vet në zonën e
10 vet, të bëj vendimet dhe të vazhdon më tutje. Ne vetëm kemi
11 marrë -- mund të kemi informacionin që kanë ndodhë ato, po çka
12 ka ndodhë dhe si është aty brenda nuk kemi dit më mirë se vetë
13 komanda e asaj zonës ose komandanti i kësaj zone.

14 Për atë dhe kur kemi dhënë ne këtë këshillë, unë nga
15 aspektet profesionale siç i përket dhe drejtorisë operative
16 për operacionet, që ne këta asi presione nuk kemi leju, nuk
17 jemi pajtuar ose kemi dhënë dritën e gjelbër për këtë veprime.
18 Po komandantët e zonave nganjëherë kanë vepruar, po dhe
19 nganjëherë nuk kanë vepruar në krye në veti.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka qenë problem ky, pra,
21 ka qenë problem që ndonjëherë komandantët e zonave, sikurse e
22 thatë, refuzonin të bënin atë çka ju kërkohet dhe vepronin me
23 kokën e vet? A ishte problem ky për ju personalisht he për
24 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur masa pasuese ose
2 masa të tjera të ndërmarra prej jush pasi komandant Remi bëri
3 atë çfarë donte të bënte dhe nuk u tërhoq nga fronti i
4 Podujevës?

5 PË. Po jo nga aspekti i saj nuk ka mujt me kë masë të japim
6 ne në atë kohë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga pikëpamja ushtarake ose
8 duke marrë parasysh përvojën tuaj ushtarake, a ishte ky një
9 problem i zakonshëm ushtarak, që ushtarët, komandantët në
10 terren merrnin vendimet e veta sipas kokës së tyre dhe nuk
11 ndiqnin këshillat e dhëna nga eprorët?

12 PË. Po kjo është një problematikë të një ushtrie të tillë si
13 ka qenë te ne, në atë kohë që u zhvillue Ushtria Çlirimtare e
14 Kosovës. Te ushtritë e rregullta jo, do ishte me i marrë masat
15 adekuate se do të kishin një sistem tjetër. Po te ne ka pasur
16 këto ndodhitë, po ndonjë masë të veçantë nuk kemi mujt të
17 marrim në atë kohë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni ndonjë
19 incident tjetër ku komandantët e zonave ose komandantët lokalë
20 i shpërfillnin këshillat që u jepeshin atyre nga drejtoria
21 operative brenda Shtabit të Përgjithshëm?

22 PË. Po mund të japim edhe rastin dhe sulmin që është bë në
23 Ballaqevc është bë pa lejen e shtabit, faktikisht, pa dritën e
24 gjelbër të drejtorisë operative. Është dhe një ndër to që
25 është bërë një veprim i tillë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur ka ndodhur kjo? Në cilin
2 vit?

3 PË. Në 1998 është. Dhe ka ndodhur diku nuk di a ishte gushti a
4 cili muaj që është bë sulmi në Bellaqevc në nyjën
5 sipërfaqësore ku zona nuk ka kërkim, as komanda e zonës nuk ka
6 kërkuar një pëlqim të tillë nga drejtoria operative për
7 operacion të tillë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po më vonë, a mund të na
9 jepni një shembull kur ka ndodhur një rast i ngjashëm?

10 PË. Nuk e di. Tash s'po më kujtohen dhe kur tjerat. Raste
11 tjera janë. Por operacionet më të mëdhaja të tilla që kanë
12 mundur të ndodhë, kanë ndodhë qato kohë çka më kujtohet.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka qenë ky një problem i
14 zakonshëm ose i rëndomtë gjatë gjithë luftës apo ka ndryshuar
15 sjellja gjatë luftës, për shembull, në 1999 pas ristrukturimit
16 ose pas nëntorit të 1998, pas ristrukturimit të Shtabit të
17 Përgjithshëm? A ka ndryshuar situata apo ka qenë kjo pak a
18 shumë problematike gjatë gjithë luftës?

19 PË. Po problematike ka qenë çdo herë në tërësi deri në
20 përfundimit të luftës. Mirëpo si pjesë operacionale ose
21 veprimet operacionale siç kanë bërë këto më herët nuk ka pas
22 më shumë. Më shumë shumë pak nuk më kujtohet që ka mujt të
23 ketë qenë ndonjë ndodhi e tillë e veçantë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani z.
25 Zyrapi, dëshiroj t'ju pyes lidhur me një temë tjetër që është

1 trajtuar gjatë kundërpyetjeve të avokatëve të Thaçit dhe
2 Veselit.

3 Keni konfirmuar që në verën e vitit 1998 kur pretendohet
4 që civilë serbë u rrëmbyen gjatë sulmeve në Rahovec, ju nuk
5 keni pasur aftësinë, për shembull, për të arrestuar
6 komandantin e zonës sepse ju nuk keni pasur një njësi të
7 policisë ushtarake në dispozicionin tuaj si drejtor i
8 drejtorisë operative. A ju kujtohet kjo?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më tej keni konfirmuar si
11 gjatë kundërpyetjeve nga Mbrojtja e Thaçit dhe nga Mbrojtja e
12 z. Selimi që ju ose Shtabi i Përgjithshëm nuk keni marrë masa
13 disiplinore sepse nuk keni pasur strukturat e duhura për të
14 marrë masa të tilla. Kjo mund të lexohet në faqen 17589 të
15 transkriptit, citoj çfarë keni thënë:

16 "Gjithçka që mund të bënim ne eventualisht ishte që të
17 zëvendësonim oficerin në fjalë nga pozicioni drejtues edhe ta
18 hiqnim atë".

19 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjatë kundërpyetjeve, z.
20 Zyrapi?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, dëshiroj të di
23 nga ju lidhur me këtë pyetje. A e dini në qoftë se oficerë ose
24 ushtarë në fakt janë zëvendësuar apo janë hequr pasi keni
25 mësuar lidhur me pretendimet për rrëmbimin e civilëve serbë?

1 PË. Po ç'a i përket asaj komplet, si për rastin e Rahovecit,
2 unë e kanë shpjeguar sesi ka ndodhë edhe kush e ka dhënë, kush
3 e ka filluar këtë veprim. Tash një masë paraprake ndaj
4 komandantit ose udhëheqësit që ka udhëheqë atëherë shtabin
5 lokal të Rahovecit, nuk ke mujt të marrin se është vra gjatë
6 ofensivës gjatë luftimeve në Rahovec. Dhe kështu s'kam mujt të
7 marrim masa ndaj tij veç kur nuk ka qenë edhe gjallë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nëse nuk gabohem i keni
9 thënë Mbrojtjes së Selimit në datën 10 korrik 2024, në faqen
10 17933 të transkriptit që rrëmbimi i pretenduar i serbëve - z.
11 Roberts i quajti ata të burgosur - nuk është diskutuar brenda
12 Shtabit të Përgjithshëm ose nuk është diskutuar dhe në
13 anëtarët e tij, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, e saktë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk është diskutuar
16 asnjëherë në qoftë se pretendimet kundër UÇK-së kanë qenë të
17 vërteta apo të sakta, këtë po thoni, apo jo?

18 PË. Po në përgjithësi nuk është diskutuar. Së paku me mua,
19 unë foli personalisht për vete, se fillimi i Rahovecit më
20 shumë deri në shtator, domethënë, kanë qenë ofensivat. Unë
21 s'kam pas kohë të vet për asgjë po as të bisedojmë për këto
22 çështje në atë kohë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Personalisht a keni pyetur
24 ndokënd në qoftë se këto pretendime kanë qenë të vërteta ose
25 të rreme?

1 PË. Jo, se pikë së pari nuk e kam dit këto. Kur e kam marrë
2 vesh mbasandaj vonë shumë për këtë ndodhi.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur biseda në Shtabin
4 e Përgjithshëm ose ndërmjet anëtarëve të Shtabit të
5 Përgjithshëm në gusht të 1998 pasi pretendimet u bënë publike,
6 sikurse e thatë juve, apo edhe më vonë sesa kjo kohë, për sa i
7 takon trajtimit të personave të përfshirë në rrëmbimet e
8 pretenduara të civilëve të tillë?

9 PË. Jo. Thashë se veç edhe gushtit i tërë ka qenë me sulme
10 dhe unë nuk kam pas mundësi as të bisedoj për këto çështje.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, ajo çfarë dua të
12 kuptoj është që, sikur thënë në intervistën e ZPS-së, në
13 Pjesën 3, në faqen 14, ju keni dëgjuar nga media nga fundi i
14 gushtit të 1998, sa i takon pretendimeve për rrëmbimin e
15 civilëve serbë dhe që keni dëgjuar po ashtu edhe për mohimin
16 se është bërë kjo gjë nga UÇK-ja.

17 Kështu që dua të kuptoj sesi janë mohuar pretendimet në
18 qoftë se nuk ka pasur burime për të hetuar në qoftë se
19 pretendimet ishin të rreme ose të vërteta dhe në qoftë se nuk
20 ka pasur diskutime midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm?
21 Kështu që si mund të dilej në këtë përfundim në qoftë se nuk
22 bëhej, për shembull, ndonjë hetim ose nuk ishte parë situata
23 për të parë ose për të konstatuar në qoftë se pretendime të
24 tilla mund të ishin bërë, le të themi, nga propaganda serbe?

25 PË. Z. Prokuror, unë e ceka. Unë nuk kam mujt të bëj ato për

1 shkak të ofensivave dhe lëvizjes tyne. Kështu që s'kam mujt as
2 të ndëgjoj a kan diskutu ndonjë send mes veti anëtarët e
3 shtabit apo kanë pru një mendim apo kanë dhënë një deklaratë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa për të qenë të qartë
5 lidhur me këtë, nuk e kisha fjalën për ju. Për ty
6 personalisht. Ose nuk sugjerova që duhet të kishe bërë ti
7 kërkime ose duhet të kishe marrë vesh ti personalisht vetë.
8 Megjithatë, le të vazhdojmë më tej.

9 Z. Zyrapi, keni diskutuar më datën 4 korrik 2024 me
10 Mbrojtjen e z. Thaçi rolin e Azem Sylës si komandantin e
11 përgjithshëm të UÇK-së. Na keni thënë që shefi i shtabit ose
12 si shef i shtabit, ai ka marrë urdhra dhe udhëzime nga z. Syla
13 kur z. Syla ka qenë brenda vendit, keni thënë dhe kur ai mund
14 t'jua dërgonte këto urdhra. Këtë e keni thënë në faqen 17627
15 të transkriptit.

16 A ju kujtohet ta keni thënë këtë më datën 4 korrik ose
17 gjatë kundërpjeteve të bëra nga Avokati i z. Thaçi?
18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur z. Syla nuk ka qenë në
20 Kosovë, sa shpesh keni marrë urdhra ose udhëzime prej tij? Ka
21 ndodhur që, për shembull, urdhra ose udhëzime të tilla t'i
22 merrni përditë, një herë në javë, një herë në muaj? Domethënë,
23 sa shpesh jepte urdhra apo udhëzime të tilla ai?

24 PË. Jo, nuk ka mujt shumë shpesh të marrë tash udhëzime nga
25 z. Syla. Sidomos, në këtë periudhën nëntor, dhjetor. Në

1 dhjetor ka qenë veç një herë brenda kur ka hy në Kosovë kur
2 jemi takue. Që atëhere kemi pas ato, veç kur kam marrë ato
3 udhëzimet të diskutoj me z. Sylja. Ma herët jo. Ma herët kur
4 kam qenë vetë në nëntor në Shqipëri kemi diskutuar për çështje
5 të mëtutjeshme sesi duhet të shkon brenda. Këto po. Pastaj nuk
6 kam pas kontakte shpesh. Në janar e shkurt gati thua hiç.
7 Derisa në Rambuje kanë shkue, deri kur u kthy prej Rambujesë
8 kur e kam pa.

9 Në qoftë se është bë diçka që është dhënë të dërgohet me
10 shkrim atëherë është dashtë përmes korrierëve të dërgohet edhe
11 unë kam mujt me mbërrie në dy ditë, tre ditë apo varësisht
12 prej punës e lëvizjes së korrierit që ka mujt të bien një
13 shkresë apo një këshillë që mund ta jep ose ndonjë urdhër çka
14 mund ta jep komandanti i përgjithshëm. Kështu që shumë pak
15 kemi pas ato kontakte.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur keni qenë ende në
17 Kosovë, domethënë, përpara shtatorit, përpara sesa të
18 largoheshit dhe z. Sylja ishte në Shqipëri, a keni marrë
19 telefonata nga z. Sylja? A e keni marrë ju atë apo ju ka marrë
20 ai juve në telefon?

21 PË. Jo, para se të shkoj në Shqipëri jo, se unë s'kam pas
22 telefon edhe normalisht s'kam mujt të kem kontakt me të me
23 telefon.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sapo përmendët që z. Sylaj
25 po vinte ose erdhi në Kosovë dhe ishte në vend. Në intervistën

1 që keni dhënë ZPS-së, në Pjesën 14, në faqen 7 dhe në faqet
2 pasuese ju keni thënë që ai ka qenë në Kosovë në gusht 1999
3 dhe në dhjetor të 1999 për një ose dy javë, në janar të 1999
4 për katër javë ose pesë ditë, në shkurt të 1999 dy ditë
5 përpara Rambujesë dhe dy ditë pas Rambujesë. A i qëndroni
6 kësaj deklaratë që i keni dhënë Prokurorisë?
7 PË. Po. Sa më kujtohet, domethënë, gushti, po, dhjetorit, po,
8 janar është që ka ardhë kur ka ndodhë rasti i Reçakut. Dhe e
9 di se para se me shkue në Rambuje dhe kur ka ardhun nga
10 Rambujeja si grup në shkurt. Dhe pastaj nuk e pa. Vetëm kur e
11 kam pa pastaj me daljen time në Shqipëri.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në intervistën që i keni
13 dhënë ZPS-së, në Pjesën 14 dhe përsëri në faqet që përmenda më
14 herët, domethënë, faqja 7 dhe faqet pasuese, ju thoni që nuk e
15 keni parë z. Syla në qershor dhe në korrik të 1998. Dhe
16 sikurse sapo e thatë që e keni takuar atë në shtator të 1998,
17 a është e saktë kjo, z. Zyrapi?

18 PË. Po në qershor edhe në korrik, jo, nuk e kam parë në
19 Kosovë. Edhe në gusht, po. Dhe prapë në shtator kur kam dalë
20 në Shqipëri.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa shpesh e keni takuar z.
22 Syla në periudhën që ka qenë në Kosovë për shembull? Kur ka
23 qenë z. Syla në Kosovë e keni takuar një herë në ditë, dy herë
24 në ditë, me çka shpeshtësie e keni takuar atë gjatë kohës kur
25 ka qenë në Kosovë?

1 PË. Jo, në Kosovë kur ka qenë nuk e kam pa bash shpesh. Në
2 qoftë se jam takuar ndonjëherë një ditë apo në dy ditë në
3 varësi se ka nejt, se nuk ka nejt shumë brenda në Kosovë. Ka
4 nejt dy ditë, tri ditë, katër ditë, krejt varësisht prej
5 situatës që ka qenë aty. Gjatë asaj periudhe ka mund ta shof
6 dy herë apo tri herë krejt.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të vazhdojmë me një temë
8 tjetër. Z. Zyrapi, në faqen 17631 dhe 32 të transkriptit,
9 flisni lidhur me komunikimin me Shtabin e Përgjithshëm dhe
10 komandantët e zonave dhe thoni që deri në nëntor të 1998, ka
11 qenë e vështirë për ju ose për Shtabin e Përgjithshëm që të
12 komunikonte me komandantët e zonave.

13 Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së, Pjesa 14, faqja 11
14 dhe besoj që kjo pjesë ju lexua sot nga z. Misetic, nga
15 Mbrojtja e z. Thaçi, ju thoni që nga qershori deri në nëntor
16 të 1998 keni pasur pajisje Motorola vetëm që kishin zonë të
17 kufizuar mbulimi dhe që kishin rrjet të shkurtër pra. A ju
18 kujtohet t'ia keni thënë Prokurorisë këtë dhe po ashtu edhe
19 përgjigjes nga pyetja e z. Misetic?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto aparate Motorola ishin
22 aparate radio, ishin radiomarrëse-dhënëse apo ishin telefona?

23 PË. Jo, radio Motorola të cilat përdorshim në atë kohë. Në
24 frekuenca të shkurtra, nuk kanë qenë frekuenca të gjata.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Afërsisht çfarë zone

1 mbulonin këto aparate, në qoftë se e dini, çfarë rreze

2 mbuluese kishin?

3 PË. Faktikisht, me to varësisht prej ku ka mujt antenat të

4 jonë ose të vendosur këto, po zakonisht kemi mujt pesë deri në

5 dhjetë kilometra më tepër s'ka mujt unë të kem një kontakt

6 njëni me tjetrin.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sot keni thënë se ti

8 personalisht nuk ke pasur një telefon të lëvizshëm, telefon

9 mobil, po një aparat një radiomarrëse-dhënëse si, për

10 shembull, Motorola a keni pasur në verën e 1998?

11 PË. Po. Kam qenë, kam pas një Motorola, por telefon jo.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni pa ushtarë të tjerë

13 të UÇK-së që kanë përdorur telefona mobil në atë kohë?

14 PË. Telefona mobil kanë pasun. Mobile janë kanë tjerë që kanë

15 pas varësisht prej ku e kanë ble ku e kanë marrë ato. Po

16 satelitor, jo, nuk kam pa.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kisha për telefona mobil

18 të rregullt ose telefona mobil satelitorë të rregullt për këtë

19 e kisha fjalën. Ju thatë që keni parë persona me telefona

20 mobil në dëshminë tuaj, e keni thënë këtë, apo jo?

21 PË. Po, me telefona mobil. Tash telefonat mobil i kanë

22 thjesht këto personale. Kurse telefonat satelitorë janë tjerë.

23 Se telefonat satelitor, sikur që e shpjegova që më pyeti

24 Prokurorja, që kanë qenë si në form laptopi, po, ato ma vonë.

25 Po në këtë kohë në këtë periudhë kanë pas mobile të dorës që

1 kanë qenë të vegjël po personale, jo satelitorë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa për të qenë shumë të
3 qartë lidhur me këtë pikë, personalisht ose ta them ndryshe,
4 ti nuk ke pasur një telefon privat mobil në atë kohë, apo jo?
5 PË. Jo, nuk kam pas.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Zyrapi,
7 pyetjet e radhës kanë të bëjnë me provën 1D00029-ET.

8 Do i lutesha Sekretarit që ta paraqesë në ekran këtë
9 provë. Faleminderit.

10 Z. Zyrapi, a ju kujtohet ta keni parë dhe ta keni
11 diskutuar këtë dokument me Mbrojtjen e Thaçit po dhe me ekipet
12 e tjera të Mbrojtjes?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Te pika 4 e këtij urdhri
15 thuhet:

16 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave
17 pa urdhër të komandantit të brigadës e më lartë, vetëm në
18 raste kritike të situatave luftarake apo kur kryhen vepra
19 penale të ndryshme si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, ndaj
20 individëve dhe pushtetit civil."

21 E shihni këtë paragraf?

22 PË. Po. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur ju përgjigjët z. Misetic
24 ju thatë që kjo dispozitë u përfshi se kishte ankesa dhe
25 qëllimi ishte të disiplinoheshin të gjithë ushtarët e në

1 veçanti, ata që nuk ishin nën komandë të plotë, kështu? Ju
2 kujtohet?

3 PË. Po. Po, ashtu.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Për
5 procesverbal, unë u referova faqes 17640 të transkriptit.

6 Pika 6 -- shkojmë më poshtë ju lutem.

7 Pjesa 6 e këtij urdhri përmend gjykatën ushtarake. Dhe ju
8 konfirmuat që në qoftë se dyshohej se një person ishte
9 kolaboracionist, ju e dërgonit këtë person e drejtonit tek
10 sektori juridik për masa të mëtutjeshme, kështu?

11 PË. Po, te sektori juridik është që merr masë të mëtutjeshme.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e parë në këtë
13 drejtim është kjo: A mund të na thoni kush e krijoi gjykatën
14 apo gjykatat ushtarake, në qoftë se ka pasur më shumë se një?
15 Sokol Dobruna?

16 PË. Po, mbas kësaj se faktikisht ky urdhër kur u shkrua ende
17 ka qenë në formim. Po pastaj ky sektor juridik që e ka
18 udhëhequr z. Dobruna, ai ka formuar këto.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në 4 korrik 2024 ju thatë që
20 z. Dobruna u emërua me propozim të komandantit të përgjithshëm
21 Azem Syla dhe komandantit të zonës Ramush Haradinaj të
22 Dukagjinit sepse z. Dobruna vinte nga e njëjta zonë si dhe z.
23 Haradinaj, pra, vinte nga Dukagjini dhe ai. Është në faqen
24 17642 të transkriptit kjo.

25 Kur i bëri pyetjet Mbrojtja e Krasniqit më 11 korrik 2024

1 në faqen 18084 të transkriptit të asaj dite, ju thatë si në
2 vijim dhe po ju citoj:

3 "PY. Të enjten e javës së shkuar, ju pyeti z. Misetic
4 lidhur me emërimin e z. Dobruna në nëntor të 1998 dhe ju
5 deklaruat se vendimi për emërimin e z. Dobruna u mor nga
6 komandanti i përgjithshëm Azem Syla."

7 Më pas ju pyetën, po flasim më 11 korrik është bërë ky
8 shkëmbim, ju pyeti Avokatja e z. Krasniqi:

9 "A ju kujtohet kjo?"

10 Ju u përgjigjët:

11 "Po."

12 Pyetje:

13 "Dhe dokumente të këtilla edhe nëse nënshkruheshin prej
14 z. Krasniqi, do të thotë që ai thjesht formalizonte një vendim
15 që ishte marrë nga komandanti i përgjithshëm, apo jo?"

16 Ju i jeni përgjigjur:

17 "Po, kështu është."

18 Tani unë i lutem Sekretarit të seancës të vendosë në
19 ekran provën materiale P1175 dhe në anglisht edhe në shqip. Po
20 e përsëris, P1175.

21 Z. Zyrapi, anglishtja thotë kështu, paragrafi i parë:

22 "Në takimin e mbajtur më 12 nëntor 1998 bazuar në nevojat
23 për riorganizim, ristrukturim dhe institucionalizimin në nivel
24 më të lart Shtabi i Përgjithshëm:

25 "Vendos

1 "1. Sokol Dobruna nga Gjakova me profesion avokat,
2 emërohet si shef i sektorit juridik në kabinetin e komandantit
3 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së."

4 Z. Zyrapi, që të jemi të qartë për dëshminë tuaj në këtë
5 pikë. Kush e ka marrë vendimin të emëronte Sokol Dobrunën? Ka
6 qenë Shtabi i Përgjithshëm me konsensus, a ka qenë me shumicën
7 e votave apo e ka marrë Azem Syla vetëm këtë vendim apo e ka
8 marrë ndonjë prej zëvendësve të tij?

9 PË. Takimi i 12 nëntor është mbajtur për ristrukturim të --
10 është për të përfshirë të gjitha ristrukturimi i Shtabit të
11 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe në atë
12 kohë, është bërë kërkimi që të ketë në këtë sektor që të ketë
13 njerëz me përvojë. Dhe aty janë pyetur të gjithë dhe
14 komandantët e zonave të tjera, njerëz që i kanë me përvojë të
15 sektorit juridik apo avokatë apo të ndryshëm që të propozojnë
16 për këtë drejtim të këtij sektorit. Normalisht, këtu dhe është
17 dhe aspekti i komandantit të përgjithshëm se është në
18 kabinetin e tij. Kështu që kjo ka shku në këtë mënyrë.

19 Pasi këta janë kërkuar nga ato komandantët, komandantët e
20 zonave, konkretisht zonës së Dukagjinit se Dobruna ka qenë
21 pjesë e zonës operative të Dukagjinit dhe ai është propozu nga
22 komandanti i zonës së Dukagjinit. Kështu që në këtë mënyrë
23 është dërguar në shtab. Edhe, normalisht, është pyetur edhe
24 komandanti i përgjithshëm. Dhe ky është aprovuar që të
25 vendoset në sektorin juridik dhe është vendosur që të udhëheqë

1 sektorin juridik.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është bërë ndonjë proces
3 votimi mes anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm përpara se të
4 çohet propozimi tek komandanti i përgjithshëm?

5 PË. Jo, nuk është bërë diçka e veçantë. Për shkak se ky veç
6 ka ardhë një propozim, pastaj komandanti i përgjithshëm
7 komandë ka vendosur dhe e kanë bërë urdhrin të cilin e kanë
8 vendosur në këtë drejtim. Nëse diçka e veçantë me emërime ose
9 me votime nuk ka shku në atë drejtim.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Do të doja të
11 flasim për një pikë tjetër tani.

12 Ju thatë që gjykata ushtarake që përmendet në pikën 6 të
13 provës që pamë më përpara u krijua për të trajtuar çështjen e
14 kolaboracionistëve ndër të tjera, kështu?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjykata apo sistemi i
17 gjykatave ushtarake a kishte për synim gjithashtu të trajtonte
18 rastet e kolaboracionistëve civilë, pra, që nuk ishin ushtarë
19 të UÇK-së?

20 PË. Po tjera sektori juridik nuk kemi pas. Na nuk kemi pas
21 sektorë civile në atë kohë të formuar në Kosovë. E vetmja ajo
22 është sektori juridik ky që ka qenë që ka mund t'i trajton të
23 gjitha si civile, si ato ushtarake, si të gjitha.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mesa dini ju, sa raste janë
25 gjykuar para gjykatës ushtarake po raste të civilëve apo jo-

1 anëtarëve të UÇK-së pasi u krijua kjo Gjykatë sa raste kanë
2 qenë civilë?

3 PË. Pasi u krijue?

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, pasi u krijua kjo
5 gjykatë.

6 PË. Nuk e di raste sa kanë qenë, tek ato duhet të din Sokol
7 Dobruna, se unë nuk jam marrë me çështjen. Ça kam mujt të jap
8 këshillat e mia dhe t'i jap mbështetje për mirëmbajtje dhe
9 sigurinë. Po nuk e di, nuk kam pas evidencë për atë punë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë javës së parë kur
11 dhatë dëshmi këtu dhe gjatë kundërpvetjeve nga Mbrojtja e
12 Krasniqit, ju përmendët rastin e dy druvarëve serbë që
13 pretendohet se u rrëmbyen dhe u keqtrajtuat në shkurt të 1999,
14 një prej tyre vdiq gjatë kohës që ishte i ndaluar. A ju
15 kujtohet ky rast të cilin e diskutuat dhe me Prokurorinë këtu
16 por edhe me Mbrojtjen?

17 PË. Po, më kujtohet ky rast.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse personat
19 përgjegjës për ndalimin dhe keqtrajtimin e këtyre dy druvarëve
20 u ndoqën penalisht dhe u dënuan nga UÇK-ja më pas?

21 PË. Jo, nuk e di ato çka është marrë dhe çka është veprue.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni ofruar nga z. Dobruna
23 apo ndonjë person tjetër nga sektori juridik që të jetë hapur
24 ndonjë hetim apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj
25 personave që ndaluan këta druvarët apo raste të tjera ku bëhej

1 fjalë për rrembin e keqtrajtim civilësh?

2 PË. Jo, nuk kam njohuri në ato që është bë.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më falni, besoj që ka një problem
4 tek transkripti, tek pyetja e Gjykatësit Barthe, këtu është
5 shkruar "ju ishit" duhet shkruar "a ishit ju" e pasqyruar në
6 transkript.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

8 Z. Zyrapi, unë po ju pyes për këtë sepse ju keni thënë në
9 gjykimin Milutinovic, por edhe në këtë Gjykatë, se detyrat
10 tuaja përfshinin, ndër të tjera, si shef shtabi, masat
11 disiplinore. Dhe unë prandaj po ju pyesja ju a jeni informuar
12 ju për diçka të tillë. Por ju thatë që nuk keni dijeni për
13 diçka të tillë dhe nuk jeni i informuar, kështu?

14 PË. Po, nuk jam i informu për atë çështje. Diçka që është
15 marrë ose në marrjen e ndonjë mase.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush ka qenë përgjegjës për
17 mbikëqyrjen e punës së gjykatës ushtarake?

18 PË. Komanda. Komandanti dhe kabineti i tij.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, nga ana praktike,
20 si mund ta mbikëqyrë z. Sylja punën e sektorit juridik kur ai
21 vetë ishte në Shqipëri pjesën më të madhe të kohës dhe kur z.
22 Dobruna nuk ishte i disponueshëm? Mbase ndonjëri prej
23 zëvendësve merrej me këtë punë apo mbase të dy së bashku?

24 PË. Po, në mungesë të komandantit janë zëvendësuar dhe
25 zëvendësuar punojnë ose mbikëqyrin këtë sektor.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të dy apo njëri dhe nëse
2 vetëm një, cili prej tyre?

3 PË. Të dytë e kanë pasur, po ma së shumti ka qenë zëvendës
4 Jakup Krasniqi se e kishe më afër aty.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani do të doja të kaloja
6 tek një temë tjetër. Do të doja t'ju pyesja kush ka qenë
7 përgjegjës për drejtorinë e policisë ushtarake pas krijimit të
8 saj?

9 PË. Pas krijimit të drejtorisë së policisë ushtarake është
10 emnue në detyrë Fatmir Lima.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur ndonjë person
12 përgjegjës për këtë drejtori përpara se të bëhej z. Limaj
13 personi përgjegjës?

14 PË. Jo, se nuk ka ekzistuar kjo drejtori. Unë çka di, nuk ka
15 ekzistuar kjo drejtori tek kjo drejtori është formuar në
16 ristrukturimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë
17 Çlirimtare të Kosovës.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, z. Limaj, Fatmir Limaj
19 ka qenë drejtor i parë i policisë ushtarake në nivel të
20 Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

21 PË. Po, kështu është.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë ka bërë ë përpara z.
23 Limaj, para se të bëhej drejtor i policisë ushtarake a ka
24 pasur ndonjë rol tjetër brenda UÇK-së?

25 PË. Po. Para se të bëhej drejtor i policisë ushtarake, ka

1 qenë komandant i Brigadës 121.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni dhe një
3 herë kush e emëroi z. Limaj si drejtor të policisë ushtarake?
4 PË. Drejtorisë së policisë ushtarake në ristrukturimin e
5 Shtabit të Përgjithshëm, kemi kërkuar që kush konton të
6 vendosim edhe atëherë është propozuar në shtab. Nuk më
7 kujtohet saktë prej kujt është marrë propozimi. Dhe e kemi
8 vendosur në drejtorinë e policisë ushtarake si shtab në atë
9 kohë gjatë transformimit të Shtabit të Përgjithshëm dhe
10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, parimisht e njëjta
12 procedurë si dhe me rastin e z. Dobruna, apo jo, për emërimin
13 e tij?

14 PË. Saktë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni kur është
16 emëruar saktësisht?

17 PË. Është me formimin e ristrukturimin e Shtabit të
18 Përgjithshëm. Tash, muj me kanë dikun o është nëntori, po
19 cilën kohë -- është ma vonë më duket jo më 12 e këto datat që
20 janë gjatë fillimit të transformimit. Po dikund nëntorit po.
21 Ka fundi tash s'më kujtohet saktë data cila është.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, a e dini nëse e
23 kishte marrë pozitën e shefit të policisë ushtarake -- të
24 drejtorisë së policisë ushtarake z. Limaj përpara se të
25 emërohej formalisht, e kishte marrë ndërkohë këtë detyrë?

1 PË. Nuk di si ka mujt ta marrë këtë detyrë formalisht kur
2 struktura nuk ka qenë e ndërtuar edhe nuk ka filluar
3 ristrukturimi i Shtabit të Përgjithshëm. Unë çka e di, më
4 herët para kësaj strukture nuk ka pas drejtori të policisë
5 ushtarake dhe nuk kam has në atë drejtori ose ta kish udhëheqë
6 dikush apo të kish ekzistuar kjo drejtori.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të jem i qartë, e kam për
8 punën konkrete më shumë sesa për emërimin formal. Se do t'ua
9 jap dhe arsyen pse po e bëj këtë pyetje, në faqen 17836 të
10 transkriptit ju u pajtuat me Mbrojtjen e Veselit se ndonëse,
11 për shembull, Mensur Kasumi nuk ishte emëruar formalisht si
12 zëvendësi i z. Veseli si shef i drejtorisë informative, ju
13 thatë që, nga prilli i 1999, z. Kasumi i kishte filluar t'i
14 ushtronte disa nga detyrat e tij përpara se të merrte emërimin
15 formal.

16 Prandaj jua bëra dhe këtë pyetje për z. Limaj, mos po i
17 ushtronte ndërkohë ai disa detyra të policisë ushtarake
18 përpara se të merrte emërimin?

19 PË. Jo, shka e di unë nuk kam pasur dijeni edhe nuk ka pas
20 ushtrime të tilla, detyra të tilla.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A jeni në
22 dijeni të jetë bërë ndonjë ankesë nga nivelet më të ulëta në
23 nivel zone drejt, që t'ia kenë, për shembull, të jenë ankuar
24 drejt Shtabit të Përgjithshëm? Ankesa, për shembull, të llojit
25 që policia ushtarake në nivel brigade t'i raportonte

1 drejtpërdrejt drejtorisë së policisë ushtarake pasi u krijua
2 apo që sekretariati informativ në nivel brigade po ashtu t'i
3 raportonte drejtpërdrejt drejtorisë informative pa u
4 raportuar fillimisht komandantëve të zonave? Keni dëgjuar
5 ankesa të tilla?

6 PË. Dëgjoni, ristrukturimi kur ka filluar, te shumë njerëz të
7 cilët kanë qenë në këto pozita dhe detyra nuk i kanë ditë
8 detyrat e veta dhe përgjegjësitë. Dhe shumica kanë menduar se
9 mendimet e veta veprojnë si të mendojnë ata. Është e vërtetë
10 që ka pas edhe të tillë që e kanë menduar, mirëpo, jo.

11 Strukturime, strukturimin kanë filluar çdo herë këto
12 sektorë juridike -- sektorët e inteligjencës ose zbulimit
13 kundërzbulimit në zonat operative dhe brigadave i raportojnë
14 komandantëve të vet. Mund të ketë një pjesë profesionale e
15 cila kërkohet nga shtabi për lëvizjet e forcave serbe dhe
16 diçka çka është me rëndësi të dërgohet ne shtab. E dyta,
17 policia ushtarake i ka dhënë përgjegjësi komandantit të zonës,
18 ai i brigadës, brigadës. Nuk ka dhënë përgjegjësi me thënë po
19 të jep më nalt dhe të jep raporte të drejtpërdrejt në këto
20 sektorë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dëgjuar ankesa që,
22 për shembull, gjatë kohës që komandant Drini ishte komandant i
23 zonës operative, në nivele më të ulëta në zonën e tij t'i
24 raportonin drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm, çka do të
25 thotë që nuk u raportonin komandant Drinit, por që i

1 raportin anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm duke
2 anashkaluar komandant Drinin?
3 PË. Është një. Po, ka qenë një herë një ankesë. Ato, sidomos
4 ky i zbulimit kundërzbulimit. Nuk e di a ka vepruar në ato dhe
5 ka i ka raportuar, unë nuk di kujt ka mujt me i raportu ai në
6 atëkohë kur e ka marrë atë detyrë, por atë që e ka zëvendësuar
7 z. Veseli atij nuk i ka raportuar për këto çështje. Kanë qenë
8 ato, po dhe kjo çështje. Pastaj komandanti i zonës ka marrë
9 masa dhe ka rregulluar këtë çështjen e raportimit, meqenëse
10 njerëz të tillë si z. Qadraku dhe kanë menduar dhe në kokë të
11 vetit se ata së pari nuk dinë detyrën e vet.

12 Edhe si mbas atyre, ata u dasht t'i raportojnë edhe
13 drejtori të tjera këtyne. Që s'është me rregull kurrfarë, se
14 dihet që janë, mund të bashkëpunojnë edhe të koordinojnë punët
15 më mes veti, por jo t'i raportojnë njëni-tjetrit. Po raportimi
16 dihet që i raportojnë këta në këto sektorë, po edhe
17 komandantëve të zonave dhe pastaj pas konsultimit me to mund
18 të shkojnë informacionet dhe më lart ato çka janë për t'u
19 bartur në nivelin më të lart dhe ato tjerat mbahen në kuadër
20 të zonës. Kanë pas mendime të tilla, po jo shumë të cilën ka
21 mund të ndodhë dhe ma tutje.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e
23 tjera i kam lidhur me dëshminë e 8 korrikut 2024 dhe atë që
24 keni thënë gjatë kohës që bëri pyetje Mbrojtja e Veselit.

25 Kjo është një faqen 17795 të transkriptit ku konfirmuat

1 se i caktimit të detyrave brenda Shtabit të Përgjithshëm dhe
2 ndarja e detyrave mes individëve të ndryshëm ka filluar në 12
3 nëntor të 1998 dhe vijoi. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?
4 PË. Po, më kujtohet.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen tjetër që do të
6 thotë është faqja 17796 e transkriptit, ju pyeti z. Emmerson
7 nëse keni qenë ju personalisht si shef shtabi që e keni marrë
8 vendimin që z. Veseli të emërohej për shërbimin informativ dhe
9 të dërgohej në Shqipëri për trajnim në nëntor dhe ju e
10 konfirmuat dhe keni thënë që:

11 "Po, unë e mora vendimin që ai të shkonte për trajnim."

12 Më pas, z. Zyrapi, në të njëjtin transkript dhe z.

13 Emmerson tha kështu:

14 "Edhe një herë po thoni që ju e keni emëruar z. Veseli te
15 G2 në nëntor dhe pastaj e çuat për trajnim te shërbimi
16 informativ shqiptar pak më pas."

17 Dhe ju përgjigjët:

18 "Po, kështu ka qenë."

19 Që të jemi të qartë për dëshminë tuaj edhe një herë, e
20 emëruat ju z. Veseli si shef të shërbimit informativ ose të G2
21 në nëntor të 1998 siç e tha z. Emmerson?

22 PË. Jo. Është, mund të jetë propozim që u është dhënë por atë
23 e emëron komandanti pozitë e drejtorëve. Është e vërtetë që
24 unë e kam dërguar në trajnime. Mund të jetë kjo pjesë që është
25 pak përzi dhe e dhënë që e kam vendos dhe si në këtë pozitë.

1 Propozimi, po, shkon nga unë, por komandanti është që ka
2 vendosur në pozitën e drejtorit të zbulimit kundërzbulimit.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po pse e
4 propozuat ju z. Veseli në këtë pozicion si shef të shërbimit
5 informativ? Për cilat arsye?

6 PË. Për arsye se e ka udhëheqë drejtorinë informative më
7 herët dhe normalisht është vazhdimësi në të cilën
8 ristrukturimi i shtabit është bërë dhe ai të vazhdon këtë
9 drejtori ta zhvillon. Për atë dhe është propozuar.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e
11 radhës janë mbështetur në paragrafin 17 të Shënimit Përgatitor
12 2, ku i keni thënë ZPS-së, pra, Prokurorisë gjatë seancës
13 përgatitore që gjatë shtatorit dhe nëntorit 1998 burimi i
14 informacionit për zhvillimet në Kosovë ishin Azem Syla dhe
15 Kadri Veseli. Ju bënë pyetje lidhur me këtë por vetëm për z.
16 Syla ju pyeti Mbrojtja e Krasniqit. Sot Prokurorja në faqen 6
17 të transkriptit ju pyeti kështu dhe po citoj:

18 "A keni pasur kontakte me Kadri Veselin gjatë kësaj
19 periudhe kohore?"

20 E kishte fjalën për periudhën shtator, nëntor 1998 --
21 shtator, tetor - më falni. Ju u përgjigjët:

22 "Kisha kontakte me Kadri Veselin pasi u ktheva nga vendet
23 perëndimore dhe filluam negociatat, diskutimet me qeverinë
24 Bukoshi, por jo më përpara."

25 Tani do t'ju pyes, së pari, z. Zyrapi, kur jeni kthyer

1 saktësisht, ma merr mendja, në Shqipëri?

2 PË. Në Shqipëri prej nga perëndimi jam kthyer në fund të
3 tetorit. Datën nuk e di saktë, s'po muj me mend tash.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përpara sesa të ktheheshit
5 në Shqipëri, nuk ke folur asnjëherë me Kadri Veselin?

6 Asnjëherë nuk e keni marrë në telefon Kadri Veselin ose
7 asnjëherë s'ju ka marrë ai ju në telefon?

8 PË. Çka e di unë në atë kohë jo, s'jemi takuar. E di që
9 telefoni i fundit që kur kam bisedue ditën, domethënë, në
10 pjesën e fundit të tetorit kur më është thirr, më ka thirrur
11 Kadri Veseli dhe më ka thënë të vij të kthehna në Tiranë se
12 duhet të vazhdojmë disa bisedime. Atëhere, që atëherë ka qenë
13 kontakti i parë telefonik, sa më kujtohet tash. Edhe më pastaj
14 kur jam kthyer në Tiranë kemi pasur -- kemi shkuar së bashku
15 fizikisht jemi taku dhe kemi fillu bisedimet me qeverinë
16 Bukoshi.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pasi u ktheve në Shqipëri,
18 çfarë lloj informacioni keni diskutuar me z. Veseli?

19 PË. Po informacion kemi bisedu ato për çështjen e bisedimeve.
20 Jo nga për mbrenda, për mbrenda nuk kemi diskutu. Kemi diskutu
21 për çështje të bisedimeve që duhet të fillojnë me qeverinë
22 Bukushi dhe ku do të mbahen këto takime.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, keni diskutuar çështje
24 politike, këtë po thoni?

25 PË. Po, gjatë për bisedimet.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni diskutuar gjithashtu
2 edhe çështje ushtarake si, për shembull, situatën e njësiteve
3 në Kosovë?

4 PË. Situatën e njësiteve në Kosovë, jo, s'kemi diskutuar në
5 çështje. Kam diskutuar vetëm për çështje, domethënë, ushtarake
6 kur kemi fillu të bisedojmë me Ministrinë e Mbrojtjes të
7 qeverisë Bukoshi.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk jam i sigurtë në qoftë
9 se transkripti është i saktë apo jo? Pra, sipas asaj çfarë
10 regjistrohet këtu thuhet që:

11 "Ne kemi diskutuar për çështje ushtarake kur filluam
12 bisedat tona me ministrinë brenda qeverisë Bukoshi."

13 Domethënë, keni diskutuar çështje ushtarake, apo jo, këtë
14 thatë më vonë?

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] E di që nuk dua të them diçka për
16 dëshmitarin --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
18 keni kundërshtim mund ta nxjerrim dëshmitarin nga salla.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ndoshta do ishte më mirë. Nuk kam
20 ndonjë kundërshtim, po kam një sqarim, kështu që do ishte më
21 mirë që sqarimin ta bëja pa praninë e dëshmitarit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 vazhdoni, z. Emerson.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Lidhur me bisedat, me bisedimet
2 në negociatat e Bukoshit midis z. Veseli, z. Zyrapi, ku ka
3 qenë i përfshirë z. Veseli dhe z. Zyrapi, këto kanë qenë
4 kryesisht biseda, kryesisht ushtarake sa i takon dy forcave të
5 armatosura. Mendoj se kjo është ngatërresa, kjo është
6 paqartësia që del ose që i shkaktohet dëshmitarit, kështu që
7 për këtë arsye u ngrita për të dhënë sqarimin, domethënë,
8 ishte pjesërisht një diskutim ushtarak që po ndodhte ose që ka
9 ndodhur me qeverisjen Bukoshi për bashkimin e burimeve të
10 ndryshme. Kjo thjesht për t'ju sjellë juve në vëmendje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë në
12 rregull. Do shohim në qoftë se mund ta sqarojmë këtë çështje.

13 Mund ta sillni përsëri dëshmitarin në sallë.

14 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
15 këshillohen]

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 z. Zyrapi. Do të vazhdojmë më tej me pyetjet e Gjykatësit
19 Barthe për ju.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Dhe mirë se erdhe, z. Zyrapi. Sapo na thanë që negociatat
22 me qeverisjen Bukoshi kanë pasur dimension ushtarak dhe mbas
23 kjo mund të krijojë paksa paqartësi.

24 Kur e kisha fjalën për çështjet ushtarake, kryesisht e
25 kisha fjalën për trupat ose për njësitë e UÇK-së në terren në

1 Kosovë në atë kohë. Dhe në qoftë se nuk e kam gabim, keni
2 thënë që kjo nuk ka qenë problem. Domethënë, kjo nuk është
3 diçka që është diskutuar me z. Veseli kur jeni takuar me të në
4 Shqipëri, është e saktë kjo?

5 PË. Po, saktë është.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është diskutuar kjo midis
7 juve të dyve, domethënë, z. Veseli dhe teje, pas bisedimeve,
8 domethënë, pas fillimit të bisedimeve për sa i takon situatës
9 së trupave që ishin në terren në Kosovë, e keni diskutuar këtë
10 me z. Veseli, z. Zyrapi?

11 PË. Jo dhe aq shumë, se për shkak se unë një pjesë të madhe
12 të kësaj deri në shtator e kam dit qysh është gjendja e
13 njërive mbrenda në territorin e Kosovës dhe kemi prit, se
14 ndryshimet kanë ndodhur dhe gjatë shtatorit dhe tetorit.
15 Kështu që nuk kemi mujt të diskutojmë ato derisa të hyjmë
16 brenda të marrim informacion brenda për brenda sesi a gjendja
17 brenda territorit të Kosovës.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga bisedat, nga diskutimet
19 me z. Veseli, a ju është krijuar përshtypja që z. Veseli po
20 ashtu ishte në dijeni të situatës së trupave në terren në
21 Kosovë?

22 PË. Po, nuk kemi bisedu në atë çështje fare, për bisedat
23 brenda për brenda njërive si janë në terren. Se dhe besoj se
24 edhe ai vetë nuk i ka ditur sesi kanë qenë njësitë brenda
25 territorit të Kosovës në çfarë gjendje janë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të më thoni arsyen se
2 pse nuk e keni diskutuar këtë me të? Se nuk ishte relevante
3 kjo për bisedimet me qeverisjen e Bukoshit? E kam fjalën këtu
4 për situatën e trupave në terren. Domethënë, nuk e keni
5 konsideruar këtë si një temë të rëndësishme ose relevante për
6 diskutim me biseda të mëtejshme?

7 PË. Jo, aty nuk ka qenë relevante për ato nëse bisedimet që i
8 kemi bërë brenda ka qenë për sistemin e unifikimit të një dhe
9 të ministrisë së Bukoshit edhe njësive që kanë qenë pranë
10 Bukoshit dhe njësive brenda, prej komandës dhe më poshtë, por
11 jo dhe në çfarë gjendje janë brenda se nuk ka mujt të
12 diskutojmë në ato, as nuk është diskutu në takime.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Zyrapi,
14 tani kam disa pyetje të tjera të cilat do të doja t'ju
15 pyesja, pra, dua të sqaroj disa çështje të tjera me ju. Një
16 prej këtyre pikave ka të bëjë me z. Rexhep Selimi që ka
17 përdorur ose që është përpjekur që të përdorë njësinë e
18 përgjigjes së shpejt të Shtabit të Përgjithshëm për arrestimin
19 e njerëzve.

20 Në përgjigjen që i keni dhënë pyetjes së bërë nga ZPS-ja
21 në faqen 17443, ju keni thënë që njësia e ndërhyrjes së
22 shpejtë është përdorur nga Rexhep Selimi në një rast në rolin
23 e tij si inspektor i përgjithshëm në territorin e zonës së
24 Pashtrikut, domethënë, një prej fshatrave në territorin e
25 zonës së Pashtrikut, dhe për këtë arsye ju keni lëshuar një

1 urdhër që është pranuar si provë dhe ka numrin e provës
2 P00901, faqja 6967 në anglisht edhe faqja 6968 në shqip.

3 Nuk besoj që është e nevojshme a shfaqim.

4 Gjatë kundërpvetjeve, megjithatë, Mbrojtja e z. Selimi ju
5 bëri këtë pyetje dhe citoj, pra:

6 "PY. Unë me mënyrën sesi e kuptoj unë këtë dokument,
7 domethënë, ky urdhri ose kjo prova e pranuar materiale është
8 që z. Selimi përpiget që të përdorë këtë njësit?"

9 Dhe ju përgjigjeni, ndërmjet të tjerash, unë citoj që:

10 "... z. Selimi nuk e ka përdorur atë për arrestimin e
11 njerëzve po është një njësi që duhet të jetë gjithmonë e
12 gatshme për të ndërhyrë."

13 Z. Zyrapi, a ju kujtohet ta keni thënë këtë --

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- në përgjigje të pyetjes?

16 PË. Po, e saktë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja ime për
18 ju është kjo: Z. Rexhep Selimi, aktualisht a e ka përdorur
19 njësinë atëherë apo thjesht u përpoq që ta përdorte, po nuk e
20 përdori?

21 PË. Jo, e ka përdorur njësinë. Por njësia ka qenë për masat
22 disiplinore në atë fshat, por jo për arrestime. Nuk ka bërë
23 arrestime në atë. Dhe pse kjo njësi nuk duhet të përdoret për
24 ato, ka qenë policia ushtarake e formime, në qoftë se ka pas
25 mungesë të policisë ushtarake nalt në Shtabi i Përgjithshëm ka

1 mujt të marrin nga zonat dhe të vepron në këtë drejtim. Për
2 shkak se këto njësité që janë pranë shtabit, vëzhguesit
3 diversantët, për reagimet e shpejta janë që janë të gjithnjë
4 çdo herë të gatshëm për nevojat e reagimit nëse ka ndonjë sulm
5 ose ka nevojë për veprime të tjera të shtabit, por jo për masa
6 disiplinore ose për arrestime.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Cila masë disiplinore u mor
8 ose u ekzekutua dhe ndaj kujt u mor kjo masë disiplinore, z.
9 Zyrapi?

10 PË. Kjo masë disiplinore është marrë ndaj ushtarëve të cilët
11 kanë hy në fshatin -- në atë fshat ku nuk ka qenë në
12 kontrollin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shumica i ka
13 përdorë telefonat në ato vende çka gjatë bisedimeve mund të --
14 kur kanë biseduar me këna kanë biseduar ushtarët, të mund të
15 japin edhe informacione të tjera të cilat telefonat, si shifet
16 dhe sidomos ata që kanë qenë telefonat në atë drejtim që kanë
17 qenë këta të fiks dhe mobil, ata janë përgjuar nga forcat
18 serbe. Për ato dhe normalisht shëtitja me uniformë në atë
19 fshat që nuk ka pas nevoja të jenë, këto janë masat
20 disiplinore që është ndërmarrë ndaj tyre ushtarëve që të
21 largohen nga ai vend dhe të mos shfrytëzojnë këto telefonat
22 dhe të folin sende të cilat mund të dalin dhe sekretet e
23 ushtrisë në atë kohë. Për këto është masa disiplinore është
24 marrë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund t'ju pyes dhe një

1 herë cila ka qenë konkretisht masa disiplinore? Çfarë kanë
2 bërë i kanë sekuestruar telefonat? E kam fjalën këtu për
3 njësinë e ndërhyrjes së shpejtë.

4 PË. Jo, ato i kanë larguar prej atyjtë ushtarët nga ky fshat.
5 Telefonat s'kanë mujt t'i marrin se telefonat fiks kanë qenë
6 të pronarëve civilë të atij fshatit. Edhe kështu që kjo ka
7 qenë masa të cilën është marrë largimi i ushtarëve nga ky
8 territor, nga ky fshat.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A i kanë hequr ushtarët me
10 forcë apo si funksionoi kjo, si është realizuar në praktikë,
11 në qoftë se e dini?

12 PË. Në praktikë është normalisht edhe me forcë u largua aty.
13 Se ka pas dhe tjerë që nuk kanë dëgjuar kanë dash të
14 vazhdojnë. Por ndonjë vepër dhe kështu çka thuhet arrestime
15 ato jo, jo, nuk ka qenë. Po këto janë masat të cilat janë
16 marrë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Masën disiplinore e keni
18 urdhëruar ju?

19 PË. Jo. Kjo është urdhru prej komandantit. Që është ai
20 inspektori i përgjithshëm është ai që i kontrollon këto masat
21 dhe mund të reagon si inspektor i përgjithshëm. Por jo nga
22 unë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë lidhur
24 me këtë pikë. Ka qenë një urdhër i komandantit të përgjithshëm
25 dhe urdhri është ekzekutuar nga inspektori i përgjithshëm apo

1 si?

2 PË. Po urdhri ka qenë nga komanda se sigurisht inspektori i
3 përgjithshëm që ka pas informacion në këtë që po ndodhin këto,
4 dhe për t'i vepruar ai duhet të ketë dritën e gjelbër prej
5 komandantit ose zëvendëskomandantit në ato momente.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Zyrapi, kam
7 një pikë të fundit për të cilën dua t'ju bëj pyetje dhe për të
8 cilën kemi nevojë si Trup Gjykses për sqarime.

9 Më 10 korrik 2024, në faqen 17977 dhe 8, jeni pyetur nga
10 Mbrojtja e z. Selimi lidhur me një deklaratë për shtyp, një
11 komunikatë që ka marrë numrin e provës materiale P00303 - që
12 ka të bëjë me arrestimin dhe ndalimin e dy zyrtarëve të LDK-së
13 Cen Desku dhe Jakup Kastrati. A ju kujtohet ta keni diskutuar
14 këtë çështje me Mbrojtjen e z. Selimi përpara një jave,
15 Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju është treguar dhe një
18 dokument tjetër që mban numrin e provës materiale P00300, në
19 të përmendeshin dy gazetarë serbë që pretendohen të jenë
20 arrestuar nga UÇK-ja në 18 tetor 1998. A ju kujtohet kjo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në pjesën 3 të intervistës
24 së ZPS-së, po gjithashtu edhe gjatë kundërpvetjeve të
25 Mbrojtjes së z. Krasniqi, më 10 korrik 2024, në faqen 18013,

1 keni thënë që keni dëgjuar lidhur me rastin e z. Desku dhe z.
2 Kastrati, por që nuk e dini se kush ka urdhëruar arrestimin e
3 tyre. A i qëndroni kësaj deklaratë, Dëshmitar?

4 PË. Po, saktë, se në periudhën kur janë këta arrestuar unë
5 nuk kam qenë në Kosovë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 37 të Pjesës 3 të
7 intervistës që i keni dhënë ZPS-së keni thënë që keni folur me
8 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm lidhur me rastin e z. Desku
9 dhe z. Kastrati kur u bëtë shef i shtabit. A mund t'i tregoni
10 Trupit Gjykses se me këtë keni biseduar konkretisht?

11 PË. Jo. Në atë kohë, bisedimet që kanë qenë, kur pasi u
12 liruen, se veç në atë kohë veç ristrukturimi ka fillu prej
13 shtabit, q'atëhere është çështja që kam bisedu se nuk e kam
14 ditur që janë të ndaluar këta të dy zyrtarë. Q'atë here kemi
15 diskutue. Dhe kam pyetur çka është çështja, pse është,
16 domethënë. Mirëpo ato thanë që ka qenë çështja e tyre për
17 masat që është marrë, po nuk ma shpjeguan saktë dhe çka dhe çka
18 ka ndodhë e gjitha.

19 Kështu që kjo ishte pjesë e bisedimeve që e kam marrë
20 vesh, domethënë, që janë këta të ndaluar, por jo ndonjë
21 bisedim konkret në këtë drejtim.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e keni mësuar këtë në
23 ndonjë takim të Shtabit të Përgjithshëm apo në ndonjë bisedë
24 private me ndonjë anëtar përkatës të Shtabit të Përgjithshëm
25 ose ndoshta më shumë sesa një anëtar të Shtabit të

1 Përgjithshëm, nga e keni mësuar këtë?

2 PË. Por mbasi janë liruar këta dhe është hap në opinion, ka
3 qenë një takim në shtab, gjatë një takimi që kemi pas brenda
4 shtabit. Nuk di a kanë qenë të gjithë anëtarët. Q'atëhere
5 është bisedu, q'atëhere kam pyet unë se s'e kam ditur.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini kush ka qenë i
7 pranishëm në atë takim?

8 PË. Nuk më kujtohen të gjithë kush kanë qenë aty.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet në qoftë se
10 ndonjëri prej katër të akuzuarve ka qenë i pranishëm në takim?

11 PË. Po zakonisht aty në takime dy kanë qenë prej tyre çdo
12 herë në takimet e shtabit. Në atë kohë z. Jakup Krasniqi dhe
13 Rexhep Selimi më shumti në takimet e shtabit kur janë mbajt si
14 të marrim nëntorit, si dhjetorit.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po z. Thaçi? Në intervistën
16 që i keni dhënë ZPS-së, keni thënë që në qoftë se z. Kastrati
17 dhe z. Desku janë arrestuar se kanë qenë anëtarë të LDK-së,
18 atëherë do të ketë qenë çështje politike. Këtë e keni thënë në
19 faqen 39, Pjesës 3 të intervistës tuaj. A nuk do të kishte
20 qenë kjo një çështje për z. Thaçi duke qenë se ai ishte
21 përfaqësues politik i UÇK-së?

22 PË. Po çka di në atë kohë hala nuk ka qenë përfaqësues ose
23 drejtori politik i drejtorisë politike. Në atëkohë ka qenë
24 hala drejtor për marrëdhënie me mediat dhe ndërkombëtare.
25 Tash, a ka mujt me qenë, nuk e di. Se unë kur kam ardhur në

1 atë kohë, domethënë, atëherë ka fillue ky ristrukturimi i
2 këtij shtabi dhe kësi drejtori, unë e ceka dhe ma herët, nuk e
3 di që ka ekzistuar tjetra. Por kur është formuar kjo drejtori kam
4 treguar, domethënë, prej asaj kohës. Dhe detyrën që ka kryer z.
5 Thaçi ka qenë që ajo për media dhe marrëdhënie ndërkombëtare.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Zyrapi, sipas
7 informacionit që kemi ne, z. Kastrati dhe z. Desku janë liruar
8 më 27 nëntor 1998. Dhe nëse nuk gabohem ju keni thënë që ka
9 pasur një takim pas lirit të tyre, domethënë, i takon që pas
10 27 nëntorit të 1998. A ka qenë z. Thaçi përfaqësues politik në
11 atë kohë?

12 PË. Po në atë kohë veç është propozuar që të formohen
13 drejtorinë politike por ende s'ka -- zakonisht në tërësi dhe
14 shtabi, se më duket se më 28, 29 kemi pasur një takim na te
15 shtabi, po si drejtori ende ka filluar veprimin e punës të saj
16 me ristrukturim.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni folur me ndokënd nga
18 Shtabi i Përgjithshëm lidhur me rastin e dy gazetarëve serbë
19 dhe, nëse po, me kë keni folur?

20 PË. Jo, nuk e di për dy gazetarët serbë. Mu ka treguar ai
21 dokumenti tash kur kam, domethënë, këto kohë, por nuk e di.
22 Nuk e kam ditur për ato që kanë qenë aty dhe nuk kam
23 diskutuar, veç e di që kam ndëgjju kur janë liruar pastaj ata
24 gazetarët.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk e keni diskutuar

1 rastin e dy gazetarëve serbë me askënd nga Shtabi i

2 Përgjithshëm?

3 PË. Jo, unë personalisht, jo.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Duke përfshirë këtu dhe

5 katër të akuzuarit, apo jo?

6 PË. Po, po. Unë personalisht nuk e kam trajtu, as nuk e kam

7 pyet dikën për këto çështje.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shumë faleminderit, z.

9 Zyrapi. Nuk kam pyetje të tjera për ju. Faleminderit edhe një
10 herë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Zyrapi,
12 përfunduar me kohën tuaj në Gjykatë sot. Do të takohemi nesër
13 në mëngjes në orën 9.00 të mëngjesit. Faleminderit dhe ditë të
14 mbarë. Do shihemi nesër.

15 Mund të dilni nga salla i shoqëruar nga Asistentja.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ndërpresim
18 seancën këtu. Do të fillojmë nesër prapë.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua të them që ndoshta për
20 momentin do ishte mirë që të kemi parasysh ose të diskutojmë
21 sa i takon mënyrës sesi do të vazhdojmë me pjesën tjetër të
22 javës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte
24 shumë mirë në qoftë se do të mund të përfundojmë me këtë
25 dëshmitar kësaj jave.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Keni ndonjë ide sesa mund të
2 zgjasë?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
4 Mettraux ka pyetje, Gjykatësi Gaynor ka pyetje.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] A ka të ngjarë që të na duhet
6 gjithë dita nesër me pyetjet e Gjykatësve?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk mund të
8 them që ndoshta do na duhet deri nga fundi i ditës nesër.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po çështja është që kemi deri në
10 orën 11.00 të enjten.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pyeta
12 dëshmitarin por ai më ka thënë që mund të qëndrojë dhe një
13 seancë tjetër të enjten, domethënë, edhe një seancë pas orës
14 11.00 në qoftë se kjo do të ndihmonte për të përfunduar me
15 dëshminë e tij.

16 Ka ndonjë pyetje tjetër? Në qoftë se jo, atëherë e
17 ndërpresim këtu seancën, do të përfundojmë nesër në orën 9.00
18 paradite.

19 --- Seanca mbyllet në orën 12.54

20

21

22

23

24

25